

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Emine SA.hu dhe Agim Ademi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarve F.M., nga GJ., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati N. N., nga GJ.; i akuzuari R. M., nga GJ., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati V. I., nga GJ. dhe i akuzuari B. B., nga K., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 të KPRK, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Sh. P., nga GJ., ndërsa të dëmtuarit F. dhe A. L., si dhe familjarët e tyre, sipas autorizimit i ka përfaqësuar avokati Y. H., nga GJ., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.323/2013, e datës 18.07.2014, e cila është ndryshuar dhe plotësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilën e përfaqësonte prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datat 22, 23 dhe 24 Tetor 2014; 04, 05 dhe 18 Nëntor 2014; 13 dhe 20 Janar 2015; 04 dhe 05 Mars 2015; 19 dhe 20 Maj 2015; 08, 09, 14 dhe 15 Korrik 2015, më datën 15 Korrik 2015 mori, ndërsa më 16 Korrik 2015 publikisht shpalli, kurse më datën 18 Gusht 2015, është përpiluar ky :

AKTGJYKIM

I akuzuari F.M., nga babai R. dhe nëna R., e lindur Xh., i lindur më ..., në fshatin C., Komuna e Gj., me vendbanim në Gj., rruga "...", nr. ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i ... fëmijëve, ..., ka të kryer ..., i gjendjes së ... ekonomike, ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra tjera penale,

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datën 14.11.2013, rreth orës 23.30 minuta, në rrugën "...", në afërsi të shtëpisë së tani të ndjerit F. L., në Gj., pas një konflikti verbal me të, për shkak të një problemi rreth shfrytëzimit të një rruge që shpie nga rruga kryesore, në drejtim të objektit banesor në ndërtim e sipër, pronë e tani të ndjerit F.1, i akuzuari F.M. me dashje dhe me qellim të privimit nga jeta, nxjerr nga brezi revolen e markës "... " e kalibrit... mm dhe duke shtënë me të njëjtën, e privon nga jeta tani të ndjerin A. L., si dhe tani të ndjerin F. L. (këta të dy vëllezër), në atë mënyrë që të ndjerin A. e qëllon me një të shtënë në anën e majtë të kafazit të kraharorit e që predha goditëse, pastaj depërton në zemër e mushkëri, kurse të ndjerin F.1 poashtu me dashje dhe me qellim të privimit nga jeta e qëllon me katër të shtëna dhe atë: në anën e djathtë të kokës, në anën e majtë të kafazit të kraharorit, në pjesën e përparme të kraharorit të majtë dhe një goditje tangjenciale-siperfaqësore në pjesën e përparme të krahut të majtë, ashtu që si pasojë e plagëve vdekjeprurëse, të njëjtit mbeten të vdekur në vendin e ngjarjes, ndërkohë që i akuzuari F.M., po ashtu me qellim të privimit nga jeta me dashje shtënë njëherë me revole ndaj të dëmtuarit F. L. (përndryshe djA. i të ndjerit F.1) duke e qëlluar të njëjtin në gjoks e që predha goditëse nga gjoksi depërton në boshtin kurrizor, me ç'rast shkakton thyerje të unazës së katërt torakale duke i shkaktuar të dëmtuarit me këtë rast lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për shëndetin, e më pastaj i akuzuari poashtu me qellim të privimit nga jeta, me dashje ka shtënë njëherë me revole edhe ndaj tani të dëmtuarit A. L. (përndryshe poashtu djA. i të ndjerit F.1) duke e qëlluar në anën e majtë të brinjëve: VII dhe VIII, të kraharorit të majtë dhe predha goditëse me këtë rast shkakton thyerjen e brinjëve, ashtu që për pasojë i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore,

- me këtë ka kryer veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 i KPRK.

II.

Sepse në kohë të pavërtetuar më parë, pa autorizim ka siguruar dhe mbajtur në pronësi, armën e zjarrtë, përkatësisht revolen e markës "...", e kalibrit... mm, me numër serik ... e cila armë i sekuestrohet nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, me datën 25.11.2013,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK.

I akuzuari R. M., nga babai F. dhe nëna T., e lindur D., i lindur më ..., në Gj., ku edhe jeton, rruga "...", nr. ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i shkurorëzuar, babë i ... fëmiju, ..., ka të kryer ..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

III.

Sepse më datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin numër I të këtij aktgjykimi, me dashje ka tentuar t'i privoj nga jeta tani të ndjerët F.1e A. L., si dhe të dëmtuarin F. L., në atë mënyrë që fillimisht shkon me një sëpatë në dorë, tek dyert e shtëpisë së tani të ndjerit F. L., ku ishin duke u grindur mes vete me fjalë babai i tij F.M. me tani të ndjerin F. L., por që pasi sëpatën ia nxjerr nga dora, tani i ndjeri F.1 i akuzuari R. M. me një thikë që posedonte me vete e godet tani të ndjerin F.1 në kafazin e kraharorit, me ç'rast tehu i thikës depërton, në thellësi 3 centimetra, duke e prerë mushkërinë e majtë të ndjerit, kurse pastaj, po ashtu me thikë, i akuzuari R. M. godet tani të ndjerin A. duke qëlluar, në pjesën e fytyrës, në anën e majtë, me një thellësi të plagës prej 2 cm, ndërsa në vijim të ngjarjes, i akuzuari R. M. ia merr revolen nga dora babait të tij, F.M., pasi i njëjti, tani kishte vrarë dy të ndjerët, si dhe kishte plagosur të dëmtuarit A. dhe F. L., dhe në një distancë rreth 2-3 metra, i drejton revolen të dëmtuarit F., po ashtu me dashje me qëllim të privimit nga jeta dhe revoles ia tërheqë këmbëzën tri herë radhazi, por që revolja nuk shkrep dhe vepra mbetet në tentativë,

- me këtë ka kryer veprën penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK.

IV.

Sepse më datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin numër I të këtij aktgjykimi, në mënyrë të paautorizuar, e ka marrë nga i akuzuari F.M., revolen e markës "...", të cilën edhe e ka mbajtur për një kohë,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK.

I akuzuari B. B., nga babai V. dhe nëna F., e lindur B., i lindur më ..., në K., ku edhe jeton, lagjja "...", p.n., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës

së Kosovës, ... martuar, ... punë, ka të kryer ..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë i dënuar edhe më parë për vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

V.

Sepse më datën, kohën dhe vendin e përkthuar si në dispozitivin numër I të këtij aktgjykimi, ka marrë pjesë në rrahje, në atë mënyrë që duke qenë shok i ngushtë i tani të akuzuarit R. M., fillimisht, me grushta dore, e sulmon F.1 L., e pastaj me një shkop të shkurtër druri, e godet tani të ndjerin A. L., në brrylin e majtë të pjesës së poshtme,

-me këtë ka kryer veprën penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 i KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 62 paragrafi 2 nënparagrafi 6, 69, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të akuzuarve ju shqipton :

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që, të akuzuarit F.M., për veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 i KPRK (Dispozitivi I i këtij aktgjykimi), i shqiptohet dënimi në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vjet burgim, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK (Dispozitivi II i këtij aktgjykimi) i shqiptohet dënimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet burgim.

Duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPRK, të akuzuarit F.M., i shqiptohet dënimi unik në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vjet burgim, të cilin dënim do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit R. M., për veprën penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK (Dispozitivi III i këtij aktgjykimi), i shqiptohet dënimi në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vjet burgim, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

KPRK (Dispozitivi IV i këtij aktgjykimi) i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve.

Duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPRK, të akuzuarit R. M., i shqiptohet dënimi unik në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit B. B., për veprën penale sipas dispozitivit V të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Ndaj të akuzuarve F.dhe R. M., vazhdohet paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimet e shqiptuara.

Ndaj të akuzuarit B. B., ndërprehet paraburgimi dhe i njejt i lirohet nga paraburgimi më datën 15.07.2015.

Të akuzuarve F.dhe R. M., koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.11.2013 deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, do t'ju llogaritet në dënimin e shqiptuar, ndërsa të akuzuarit B. B., koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.11.2013 e deri më datën 15.07.2015, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Konfiskohen : 1 (një) armë e zjarrit, e markës "...", e kA.brit, ..., me numër serik ... me karikator; 1 (një) armë e zjarrit, e markës "...", e kalibrit..., me numër serik "...", me karikator dhe 8 (tetë) fishekë; 2 (dy) sopata; 3 (tri) thika; 1 (një) fotrollë e thikës; 1 (një) palë dana; disa rroba; 1 (një) shufër metA.ke e ndarë në dy pjesë dhe 1 (një) drapër.

Të dëmtuarit F. dhe A. L.,³ si dhe familjarët e tyre, udhëzohen që kërkesat e tyre pasurore-juridike t'i reA.zojnë në kontest të rregullt civil.

Detyrohen të akuzuarit F.M., R. M. dhe B. B., që secili veç e veç t'a paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 200 € (dyqind Euro) dhe në mënyrë solidare ta paguajnë shumën prej 140.88 € (njëqindedyzet Euro e tetëdhjetetë cent) në emër të kompensimit të ekspertëve mjekësor, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. ECURIA E PROCEDURËS

³ Në vijim të këtij aktgjykimi, në disa raste shprehja "të dëmtuar" nënkupton, përveç A. dhe F. L., edhe të ndjerët F. dhe A. L..

1.1. Ngritja e aktakuzës dhe fillimi i shqyrtimit gjyqësor

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 18.07.2014, ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarve F.M., R. M. dhe B. B., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa ndaj të akuzuarit F.M., edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK.

Pas ngritjes së aktakuzës, menjëherë është caktuar shqyrtimi fillestar, i cili është mbajtur më datën 31.07.2014, në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjilan, ndërsa shqyrtimi i dytë është mbajtur më datën 01.09.2014.

Kryetari i trupit gjykues, më datën 02.09.2014, ka marrë aktvendim me të cilin i ka refuzuar si i të pabazuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin ndaj provave të mbrojtësve të të akuzuarve.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale ka filluar më datën 22 Tetor 2014,⁴ ku gjatë kësaj seance të shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit Shaban Spahiu, e ka bërë zgjerimin e aktakuzës, me ç'rast të akuzuarin R. M., e ka akuzuar edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupit gjykues i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat që i takojnë sipas KPP, ndërsa pas kësaj edhe është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit.

1.2. Deklarimi i të akuzuarve lidhur me aktakuzën dhe vendimet e trupit gjykues lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit F.M.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e prokurorit të shtetit, të akuzuarit F.M., R. M. dhe B. B., kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen.

I akuzuari F.M., e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, duke shtuar se jam penduar për këtë, ka kërkuar falje dhe njëherit i ka shprehur ngushëllime të dëmtuarve për vdekjen e anëtarëve të familjes.

Ndërsa, të akuzuarit R. M. dhe B. B., kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen.

⁴ Përveç procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 315 paragrafi 2 të KPP, të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe marrjen në pyetje të të dëmtuarit F. L. në shtëpinë e tij në Gj., janë regjistruar edhe me video-kamera, ku CD-të e të gjitha këtyre regjistrimeve gjenden në shkresë të lëndës.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësve të të akuzuarve dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit Y. H. ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit F.M., për kryerjen e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK (Dispozitivi II i këtij aktgjykimi), ngase ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë që parashihen në nenin 248 paragrafi 1 të KPP. Në këtë aspekt, trupi gjykues ka konstatuar se i akuzuari F.M., e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari F.M. pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk ka përmbajtur asnjë shkelje të qart ligjore ose gabime faktike.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit F.M., për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 i KPRK (Dispozitivi I i këtij aktgjykimi, por sipas aktakuzës fillestare, të paraqitur me shkrim),⁵ trupi gjykues ka marrë aktvendim me të cilin nuk e ka pranuar fajësinë, ngase ka vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për një gjë të tillë.

1.3. Fjala përfundimtare e palëve⁶

Prokurori i shtetit Shaban Spahiu, gjatë fjalës përfundimtare e ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e aktakuzës, me ç'rast të akuzuarin F.M., nga GJ., e ka akuzuar për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK; të akuzuarin R. M., nga GJ., e ka akuzuar për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ndërsa të akuzuarin B. B., nga K., e ka akuzuar për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Në fund, prokurori i shtetit, i ka propozuar trupit gjykues që të akuzuarit F.M., R. M. dhe B. B., të shpallen fajtor për kryerjen e këtyre veprave penale sipas aktakuzës së ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare dhe ndaj të njejtëve të shqipohen dënime sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, avokati Y. H., gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se e akceptojë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, përveç rikuarit të veprave penale dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

⁵ Siç është cekur edhe më parë, sipas dispozitivit I të aktakuzës së paraqitur me shkrim, të akuzuarit F. M., R. M. dhe B. B., janë akuzuar për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK.

⁶ Prokurori i shtetit, përfaqësuesi i palëve të dëmtuara, si dhe mbrojtësit e të akuzuarve F. dhe R. M., avokatët N. N. dhe V. I., fjalën përfundimtare trupit gjykues ja kanë dorëzuar edhe në formë të shkruar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., avokati N. N., gjatë fjalës përfundimtare përveç tjerash ka shtuar se i mbrojturi i tij ka vepruar në mbrojtje të nevojshme ose veprën penale e kryer në tejkA.m të kufijëve të mbrojtës së nevojshme. Nëse një propozim i tillë nuk aprovohet, atëherë i ka propozuar trupit gjykues që i mbrojturi i tij të shpallët fajtor për shkak të veprës penale vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, nga neni 180 i KPRK. Njëherit, ka propozuar që të mirren për bazë rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit.

I akuzuari F.M., është pajtuar me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. M., avokati V. I., gjatë fjalës përfundimtare i është referuar aktakuzës së dorëzuar fillimisht nga prokurori i shtetit dhe i ka propozuar trupit gjykues që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza për vepër penale të vrasjes së rëndë apo eventuA.sht në drejtin të tij të ndryshojë kuA.fikimin ligjor të veprës penale.

I akuzuari R. M., gjatë fjalës përfundimtare e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, si dhe ka shtuar se më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur, sepse edhe për familjen e tij kjo ngjarje është rëndë për shkak të lidhjeve familjare me të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. B., avokati Sh. P., gjatë fjalës përfundimtare i ka propozuar trupit gjykues që t'a lirojë nga akuza të mbrojturin e tij.

Me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij është pajtuar edhe i akuzuari B. B..

2. Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Meqë përveç veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave tjera penale, përkatësisht nuk është pranuar pranimi i fajësisë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova :

- dëgjimin e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve A. L. dhe F. L.;
- dëgjimin e dëshmitarëve A. Xh. , Sh. Xh., N. M., E. M., A. K., T. M., R. E., E. R., B. B. dhe S. R.;
- leximin e deklaratës së dëshmitarit I. L.;
- daljen dhe shiqimin e drejtpërdrejt të vendit të ngjarjes nga ana e trupit gjykues, prokurorit të shtetit, përfaqësuesit të palëve të dëmtuara, mbrojtësve të të akuzuarve, si dhe zyrtarëve policor nga Njësia e Forenzikës;
- dëgjimin e ekspertëve dhe atë : Dr.Arsim Gërxhaliu, ekspert mjeko-ligjor; Hidajete Muharremi, eksperte për Serologji dhe ADN, si dhe Qëndrim Topalli, ekspert për armë të zjarrit dhe gjurmë të veglave;

- provat materiale, siç janë : Raportet e Autopsisë për të ndjerët F. L dhe A. L., së bashku me fotografitë e të ndjerëve të bërë në Departamentin për Mjekësi Ligjore në Prishtinë; Formularët e AnA.zave të ADN-së; Raportët e AnA.zave të ADN-së; Vërtetimi për Konfiskimin e Armëve të Zjarrit; Raportëve të Ekspertizës së Armëve të Zjarrit; Listat e PTK-së për numrin e telefonit ..., si dhe i të dhënave tjera që kanë të bëjnë me këtë numër të telefonit; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me fotografitë e vendit të ngjarjes; Skica e vendit të ngjarjes, së bashku me legendën e matjeve; Raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Raporti i Shpejt i Policisë së Kosovës, si dhe raportet tjera të Policisë së Kosovës; Skicat të cilat i kanë përpiluar i dëmtuari F. L. dhe dëshmitari B. B.; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotografitë që janë nga ana e Njesisë së Forenzikës; Ekspertizat mjeko-ligjore; Raportet Mjekësore; Raporti shtesë i hetimeve, i datës 02.09.2014 dhe mesazhet telefonike; Kopja e planit dhe një Çertifikatë e Pronësisë, si dhe

- marrjen në pyetje të akuzuarve F.M., R. M. dhe B. B..

2.1. Deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1. I dëmtuari A. L., gjatë marrjes në pyetje në cilësi të dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike pasi që e ka përfunduar shkollën ka shkuar në punë te kafiteria "...", ku ka punuar deri në ora 23:00. Pas përfundimit të punës në këtë kafiteri, është nisur në këmbë për në shtëpi, ku pasi që e ka kaluar kioskën dhe është nisur në drejtim të shtëpisë së tij, e ka takuar babain e tij, tani të ndjerin F. L., i cili me një palë dana kishte qenë duke i rregulluar disa paleta të drurit të cilat kishin qenë afër rrugës që shpie nga rruga kryesore e deri te ...⁷ Së bashku me babain e tij, kishte qenë edhe axha e tij, tani i ndjeri A. L.. Pasi që i kishte përfunduar punët babai i tij, kishte ardhur i akuzuari F.M., me të cilin janë përshëndetur dhe që të katërtit së bashku kanë shkuar në drejtim të rrugës që shtëpisë së të dëmtuarve dhe gjatë kësaj kohe, i akuzuari F.M. ka thënë se "leni këto paleta se e shtrojmë rrugën bashkë dhe ai është në gjendje që ta largojë edhe kioskën e tij", ndërsa i ndjeri F. L., i kishte thënë të akuzuarit F.M., se "unë nuk po du me largu kioskën, por le ta shtron Komuna rrugën me asfalt". Pas bisedës rreth kësaj rruge, të gjithë së bashku mandej kanë hyrë në oborr të shtëpisë së të ndjerëve-të dëmtuarve. Edhe në oborin e shtëpisë është zhvilluar një bisedë në lidhje me këtë rrugë dhe i akuzuari F.M., ka insistuar që të d.A.n jashtë oborrit të shtëpisë në mënyrë që mos të bëjnë zhurmë. Pasi kanë dalë jashtë oborrit të shtëpisë, të akuzuarit F.M. ka filluar që t'i cingërrojë telefoni dhe gjithashtu edhe dëshmitarin A. L., e ka ftuar e fejuara e tij, me të cilën ka filluar që të flasë përmes telefonit dhe duke folur me

⁷ Në vijim të këtij aktgjykimi, për këtë ndërtesë janë përdorur edhe shprehje tjera, si p.sh. N. e o., N. e sh., etj.

të, ka filluar që të ec dhe ka shkuar deri te Gjelltorja "...". Në momentin kur ka qenë duke ecur afër Gjelltores "...", e ka dëgjuar një britmë e cila vinte nga shtëpia e tij dhe menjëherë e ka mbyllur telefonin, ku me vrap ka shkuar në drejtim të shtëpisë së tij. Në momentin kur ka arritur afër shtëpisë së tij, para ndërtesës e cila është pronë e familjes së tij, i ka takuar të akuzuarit F.M., R. M., B. Sh. dhe B. B.. Në ato momente i akuzuari R. M. i cili ishte me thikë në dorë e sulmonte babain e tij-të ndjerin F. L., ndërsa i akuzuari B. Sh., fillimisht e kishte goditur me grushta babain e tij, ndërsa i akuzuari F.M., para se ta nxjerrë revolën e kishte goditur me grushta axhën e tij - të ndjerin A. L.. Kurse, të akuzuarin B. B., e kishte parë me një shkop në dorë, i cili shkop edhe nuk kishte qenë edhe shumë i gjatë, ku i njëjti ishte duke marrë pjesë në atë rrahje, duke e sulmuar axhën e tij – të ndjerin A. L., mirëpo nuk e ka vërejtur se në cilën pjesë të trupit i akuzuari B. B. e ka goditur axhën e tij.

I dëmtuari A. L., i ka treguar pozicionet e personave në momentin kur ka arritur para ndërtesës së tyre, ku i njëjti ka deklaruar se babai i tij - i ndjeri F. L., kishte qenë në anën e majtë nga pozicioni i tij; axha e tij - i ndjeri A. L., kishte qenë në anën e djathtë nga pozicioni i tij; vëllain e tij-F. L. nuk e kishte parë edhe shumë, mirëpo ai kishte qenë në mes të këtyre dyve; të akuzuarit R. M. dhe B. Sh., kishin qenë në anën e majtë nga pozicioni i tij, afër babait të tij, kurse i akuzuari F.M., kishte qenë në anën e djathtë të pozicionit të tij, afër axhës së tij.

Në momentin kur i dëmtuari A. L., kishte arritur në vendin e ngjarjes, kishte tentuar që ta qetësojë situatën, duke ju thënë “ndalnu, ndalnu”, ku në ato momente e kishte parë që i akuzuari F.M., e kishte nxjerr revolën, ku i dëmtuari A. L., i cili ishte afër babait të tij, i kishte thënë të akuzuarit F. “hjeke alltinë së naj more fytyrën”, ndërsa i akuzuari F. e kishte shkrepur revolën në drejtim të dëmtuarit A. L., me ç’rast një plumb e kishte goditur të njëjtin në krahërorin e majtë. Kjo predhë i është larguar të dëmtuarit A. nga trupi i tij diku një muaj e gjysmë pasi që ka ndodhur rasti. Para se i akuzuari F. të shkrepë në drejtim të dëmtuarit A. , i njëjti ka deklaruar se nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim që t’i sulmojë të akuzuarit F., R., B. apo B., ngase edhe nuk kishte ndonjë armë apo mjet të rrezikshëm me vete. Në momentin kur është goditur me predhë të armës, i dëmtuari A. L. ka qenë larg diku rreth 5 metra nga i akuzuari F.. Pas goditjes me armë të zjarrit, i dëmtuari A. L. është rrëzuar në anën e djathtë të krahërorit, ku prindi i tij – i ndjeri F. L., ka dashur që ta kap për krahërori të djathtë dhe ta tërheq të dëmtuarin A. L. nga vendi i ngjarjes. Gjatë këtyre momenteve, babai i të dëmtuarit-i ndjeri F. L., është goditur me një predhë në krah dhe i dëmtuari A. L., kishte qenë shumë afër babait të tij. I dëmtuari A. L., ka deklaruar se babai i tij-i ndjeri F. L. është goditur me armë nga drejtimi i të akuzuarit F.. Pasi që është goditur babai i tij, i dëmtuari A. L., ka filluar që të tërhiqet nga vendi i ngjarjes dhe atë duke u larguar zhagas. Në momentin e fundit, në vendin e ngjarjes, i dëmtuari A. L. e kishte parë të akuzuarin B. B. duke e sulmuar axhën e tij-të ndjerin A. L., me një armë të ftohtë, e cila ka qenë e gjatë 20-30 cm, të cilin edhe

nuk ka mundur që ta vërejë edhe aq mirë, ngase nuk kishte ndriqim të mjaftueshëm.

Pasi është tërhequr zhagas deri të N. e B., mandej i dëmtuari A. L., ka filluar që të eci disi i krrysur deri në rrugë kryesore, me ç'rast kur ka arritur te rruga kryesore ka dëgjuar edhe disa të krisura të armës. Pas kësaj me një taksë është dërguar tek Emergjencia në Gjilan, mandej e kanë sjellur edhe vëllain e tij, F. L., të cilin e ka parë se është i plagosur. Pas kësaj në Emergjencë është sjellur edhe babai i tij, F. L., kurse pas tij edhe axha i tij, A. L., të cilët kishin qenë të vdekur. Të dëmtuarin A. L. dhe vëllain e tij, F. L., natën kritike më pastaj i kanë dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Para ndodhjes së kësaj ngjarje, raportet në mes familjeve të akuzuarve F.dhe R. M., si dhe familjes së të dëmtuarve kanë qenë të mira.

I dëmtuari A. L., gjithashtu ka shtuar se gjendjalishëndetësore e vëllait të tij F.it, nuk është e mirë, ngase i njëjti është 95 % i parA.zuar dhe sipas deklaratës së tij, i njëjti e ka njoftuar të dëmtuarin A. , se i akuzuari R. e ka lënduar me armë zjarri, ku është goditur një herë më një predhë, poashtu i akuzuari R. kishte tentuar që përsëri ta godas vëllain e tij.

Në momentin kur i akuzuari F. e ka drejtuar armën, i dëmtuari A. L., ka qenë afër babait të tij, në anën e majtë të tij, mandej ka dalur para babait të tij. Me sa ka parë, i akuzuari F., menjëherë ka shtënë në drejtim të dëmtuarit A. dhe i njëjti nuk e ka raportit armën, çka do të thotë se i njëjti e ka patur armën gati për shkrepje. Arsyeja pse ka ndodhur ky incident, ka qenë shkak i rrugës, përkatësisht vendosjes së paletave në rrugë. Përveç armës të cilin e ka mbajtur i akuzuari F., thikës të cilën e ka mbajtur i akuzuari R. mjetit të cilin e ka mbajtur i akuzuari B. dhe danave të cilat i ka mbajtur i ndjeri F.1 i dëmtuari A. L., natën kritike nuk ka vërejtur nëse ndokush ka patur ndonjë armë apo mjet tjetër në vendin e ngjarjes.

Sa i përket asaj se çka ka poseduar natën kritike i akuzuari B. B. dhe veprimeve të tij, i dëmtuari A. L., ka shtuar se para se të plagoset e ka parë që i akuzuari B. e ka patur një mjet të fortë, ndërsa pas plagosjes e ka parë se i akuzuari B. e ka patur një thikë në dorë. I akuzuari B. B., natën kritike me grushta e ka sulmuar babain e të dëmtuarin-të ndjerin F. L., ndërsa kur është plagosur i dëmtuari A. , i njëjti e ka parë të akuzuarin B. duke e sulmuar axhën e tij-të ndjerin A. L..

I akuzuari B. B., është shoqëruar edhe para natës kritike me të akuzuarin R. M., i cili edhe është iniciator i krejt kësaj ngjarje.

E tërë ngjarja që ka të bëjë me gjuajtjen me armë, ka ndodhur brenda oborrit të ndërtesës së familjes së të dëmtuarit, kështu që edhe poqa elektrike që ka qenë e vendosur te lokA. i të dëmtuarit, ka qenë e mjaftueshme për ta përcjellur ngjarjen.

2.1.2. I dëmtuari F. L., gjatë marrjes në pyetje në shtëpinë e tij⁸ ka deklaruar se para ditës kritike raportet në mes të familjes së tij dhe familjes së të akuzuarve F.dhe R. M., kanë qenë shumë të mira për shkak të lidhjeve familjare që kanë patur në mes vete. I dëmtuari F. L., ka shtuar se natën kritike, para se të ndodhte ngjarja, diku rreth orës 21:00, ka dalë nga shtëpia dhe ka shkuar me blerë diçka te marketi "...” i cili ka qenë afër kioskës, ku kishte parë se paletat afër kioskës kishin qenë të rrëzuara. Duke e parë se këto paleta ishin të rrëzuara, i dëmtuari F. L., ka shkuar dhe e ka pyetur disa taksistë dhe gjithashtu ka shkuar dhe ka pyetur edhe tek qebaptorja e R. M., se kush i ka rrëzuar, ku është njoftuar se këto paleta i ka rrëzuar E., pronari i barnatorës, i cili edhe ka sharë me këtë rast. Pas kësaj, i dëmtuari F. L., i ka rregulluar paletat dhe është kthyer në shtëpi, ku diku pas gjysmë ore, pasi që kishte shkuar në shtëpi, e kishte parë që dikush përsëri i kishte rrëzuar këto paleta. Mandej, i njëjti me babain e tij, F.1n, si dhe me axhën e tij, A. i cili ishte në oborr kanë dalur dhe i kanë rregulluar me tel këto paleta. Pasi që i kanë rregulluar paletat, kanë shkuar tek hyrja e ndërtesës dhe kanë qëndruar diku rreth 15 minuta për të shikuar nëse dikush prapë po i rrëzon këto paleta, mirëpo askush nuk i ka rrëzuar këto paleta gjatë kësaj kohe. Gjatë kësaj kohe, përveç danave te telit që i ka patur babai i tij, tjetër send nuk kanë patur me vete dhe në këtë moment A. i nuk ka qenë me ta. Mandej, janë nisur në drejtim të shtëpisë, kanë hyrë në oborr dhe në atë moment ka ardhur i akuzuari F.M., i cili ka thënë se qysh do t’ia bëjmë me ato paleta që i keni vendosur,

⁸ I dëmtuari F. L. është ftuar për të marrë pjesë në seancat e shqyrtimit gjyqësor, mirëpo i njëjti sipas vëllait të tij – A. L., nuk ka mundur që të marrë pjesë në seancë, me arsye të pamundur që të lëvizë për shkak të plagës nga arma e zjarrit. Kryetari i trupit gjykues, ka kërkuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan, që ta dërgojnë një ekip mjekësorë në shtëpinë e të dëmtuarit F. L. për ta konstatuar gjendjen e tij shëndetësore, si dhe për ta konstatuar se a ka mundësi (a është në gjendje) që i dëmtuari F. L., nga një ekip mjekësorë të sillen për të dëshmuar në një seancë të shqyrtimit gjyqësor. Nga shkresa e datës 13.01.2015, të cilin e ka përpiluar Dr.Ekrem Kryeziu, është parë që i dëmtuari F. L., nuk është në gjendje fizike dhe psikike për të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, kurse për shqyrtimin e gjendjes së tij shëndetësore, është rekomanduar që të bëhet edhe një vlerësim i ekspertëve të lëmive përkatëse, si: neurokirurgut, psikiatrit dhe psikologut. Duke u bazuar në këtë rekomandim, trupi gjykues ka marrë aktvendim që të formohet një ekip e ekspertëve të lëmive të lartcekura për të vërtetuar gjendjen shëndetësore dhe mundësinë e sjelljes së tij në Gjykatën Themelore në Gjilan, në mënyrë që i njëjti të mirret në pyetje në cilësinë e dëshmitarit. Si rezultat i kësaj, është krijuar një ekip mjekësorë në përbërje prej : Dr.Talat Gjinolli-Neurokirurg, Dr. Afrim Cana-Psikiatër dhe prof.Bekim Isaku-psikolog, cilët e kanë bërë ekzaminimin e të dëmtuarit F. L. në shtëpinë e tij. Kjo ekip mjekësorë më datën 15.01.2015, e kanë përpiluar një konstatim me këtë përmbajtje : Që të shtyhet procesi i marrjes në pyetje të dëmtuarit F. L., në një interval kohore prej 3 (tre) muajve, me qëllim që vetëm që të priten efektet pozitive të tretmanit të tij që e ka bërë në shtetin e Tajlandës, si dhe është rekomanduar që marrja e tij në pyetje të bëhet në shtëpinë e tij. Duke u bazuar në këtë konstatim të ekipit të ekspertëve mjekësor, prokurori i shtetit Shaban Spahiu, i ka propozuar trupit gjykues që marrja në pyetje e të dëmtuarit F. L., të bëhet në shtëpinë e tij, ku me këtë propozim janë pajtuar edhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, si dhe avokatët e të akuzuarve. Trupit gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe duke u bazuar në nenin 290 paragrafi 1 dhe 2 të KPP; në rekomandimin e ekspertëve mjekësor; në rrethanat që janë krijuar më vonë, si dhe duke u bazuar në faktin që raportet në mes të familjeve të të dëmtuarve-të ndjerëve dhe të akuzuarve janë tejet të acaruar, ka vendosur që marrja në pyetje e të dëmtuarit F. L., në cilësi të dëshmitarit të bëhet në shtëpinë e tij, pa prezencën e të akuzuarve, por gjithsesi me prezencën e avokatëve të tyre. Në këtë mënyrë, i dëmtuari F. L., është marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit në shtëpinë e tij më datën 19.05.2015 dhe gjatë marrjes në pyetje kanë prezentuar : trupi gjykues, prokurori i shtetit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar, mbrotjësit e të akuzuarve, procesmbajtësja, stafi teknik i gjykues, eksperti gjyqësor Dr.Afrim Cana-psikiatër, si dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës.

ndërsa i ndjeri F.1, ishte përgjigjur se paletat i kanë vendosur në pronën e tyre. Pas kësaj, i akuzuari F. ka thënë që nëse doni po e largojë kioskën, ndërsa i ndjeri F.1, ishte përgjigjur se ne nuk jemi të interesuar që ta hjekim kioskën, ngase e njëjta nuk është në pronën e tyre. Kjo bisedë ka qenë e qetë dhe normale, ku pastaj kanë dalur për ta përcjellur deri te dera që del prej oborrit të akuzuarin F.M.. Në atë moment ka ardhur i akuzuari R. M. me një sopatë të madhe në dorë dhe i njëjti është ardhur nga drejtimi i ndërtesës që është në ndërtim e sipër.⁹ I akuzuari R. M. ka ardhur duke i sharë dhe i njëjti ka marrë “hyxhym” me sopatën, me ç’rast në këtë moment, i ndjeri F.1, ka arritur që t’ia kap sopatën. Gjatë këtij momenti kur i ndjeri – F.1 ja ka kapur sopatën të akuzuarit R. i akuzuari F. është tërhequr diku rreth 1 metër në drejtim të murit të pllacit të R. M.dhe e ka nxjerr revolën, ku në atë moment edhe i dëmtuari F. e ka sulmuar të akuzuarin R. me grushta në kokë. Në atë moment kur i dëmtuari F. e ka goditur të akuzuarin R. me grushta, i ndjeri F.1 ka arrit t’ia tërheq sopatën. Pasiqë i akuzuari F.e kishte nxjerrë revolen, i ndjeri A. ka vrapuar në drejtim të tij dhe ka dashur që t’ia tërheq revolen, ku e ka drejtuar drejt tokës dhe gjatë këtij momenti ka patur përleshje në mes të akuzuarit F.dhe të ndjerit A., në njërën anë, kurse në anën tjetër, i dëmtuari F. dhe i ndjeri F.1 janë përleshur me të akuzuarin R.. Në momentin kur i akuzuari F., e kishte nxjerr revolen, ai e kishte drejtuar në drejtimin e të dëmtuarit F. dhe të ndjerëve F.1 dhe A., por më shumë e kishte drejtuar në drejtim të ndjerit F.1t. Pas këtij momenti i akuzuari R. është tërhequr dhe i njëjti ka shkuar në drejtimin prej nga ka ardhur dhe ka shkuar deri te garazha e objektit që është në ndërtim e sipër. Pasi që i akuzuari R. është tërhequr, i dëmtuari F. ka shkuar në drejtim të tij dhe kur ka arritur deri te muri i pllacit të R. M., në anën e djathtë ka parë të pandehurin B. Sh., i mbështetur për muri me një revole në dorë të kthyer në mënyrë horizontale. Sipas mendimit të dëmtuarit, edhe pse nuk ka qenë shumë i sigurt, revolja të cilin e mbante B. ka qenë e kalibrit të madh me ngjyrë të zezë dhe e markës “...”. I pandehuri B., ka bërë titur “ndalnu”, ngase i dëmtuari F. dhe i ndjeri F.1, ishin duke e ndjekur të akuzuarin R. ku në atë moment të pandehurin B. e ka sulmuar i ndjeri F.1, mirëpo i dëmtuari F. nuk e ka parë se me çka e ka sulmuar të njëjtin. Në këtë moment, i dëmtuari F. e ka parë në anën e majtë edhe të akuzuarin B. B., me një thikë në dorë, i cili ka qenë diku larg nga B. rreth 3.5 deri në 4 metra. I dëmtuari F., nuk e ka parë nëse i akuzuari B. të ketë ndermarrë ndonjë veprim, përveç që e kishte parë duke e mbajtur thikën. Kur i ndjeri F.1, e kishte sulmuar të pandehurin B.n, i njëjti është tërhequr dhe ka bërë titur “oj nanë sakica” dhe i njëjti ka shkrepur një herë në të drejtim të ndjerit F.1 mirëpo i dëmtuari F. nuk e din a e ka goditur. Distanca në mes të B. dhe të ndjerit F.1, në momentin kur i pandehuri B. ka

⁹ I dëmtuari F. L, rrëfimin e tij për ngjarjen që ka ndodhur natën kritike, përveç që ka deklaruar me gojë, e ka prezentuar edhe me disa skica, gjithsej 15 skica, ku ka treguar pozicionin e secilit person (të akuzuarve dhe të dëmtuarve-të ndjerëve) në momente të caktuara. Ai ka treguar pozicionet dhe vendin ku kanë qenë personat në momente të caktuara dhe kjo është bërë me qëllim të vërtetimit sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike. Të gjitha këto 15 skica janë pjesë përbërëse e procesverbalit të marrjes në pyetje të dëmtuarit F. L në shtëpinë e tij.

shkrepur ka qenë diku rreth gjysmë metre. Në momentin kur i dëmtuari F., ka vrapuar pas babait tij, pasi që kishte shkrepur i pandehuri B., kishte ardhur i akuzuari R. diku nga drejtimi i parkut që gjendet afër Ndërtesës së Bardhë. Në këtë moment i dëmtuari F., ka deklaruar se i akuzuari R. ka shkrepur dy herë në drejtimin tij dhe distanca në mes tij dhe të akuzuarit R. kur i njëjti ka shtënë në drejtimin tij ka qenë diku 5 metra. Në momentin kur i akuzuari R. ka shkrepur dy herë me armë, i dëmtuari F. nuk e kishte ditur se ku e kishte goditur dhe sa herë e kishte goditur, veçse e kuptuar se trupi i tij është nxehur, me ç'rast edhe kishte patur probleme me frymarrje. Pas kësaj i dëmtuari F., kishte rënë me shpinë në tokë dhe pozicioni i tij kishte qenë i tillë në atë mënyrë që fytyra e tij kishte qenë e drejtuar kah drejtimi i N. së B. dhe gjatë këtij momenti e kishte parë se i akuzuari F. ka shtënë me armë dy herë në drejtim të axhës së tij-A. dhe atë në drejtim të gjoksit së të ndjerit. Ndërsa, në këtë moment nuk e kishte parë se ku ka qenë babai i tij - i ndjeri F.1. Në momentin kur i ndjeri A. ka rënë në tokë, i akuzuari R. ka shtënë në drejtimin kah ishte i ndjeri F.1, mirëpo i dëmtuari F. nuk e din se a e ka goditur të njejtin. Pasi që ka shtënë në drejtim të ndjerit A., i akuzuari F. ka vrapuar dhe ka shkuar në drejtim të akuzuarit R. kah parku dhe e din që edhe i akuzuari F. ka shtënë në drejtim të ndjerit F.1 2 ose 3 herë, mirëpo i dëmtuari F., nuk e di saktë dhe nuk e di nëse i njëjti e ka qëlluar babain e tij – të ndjerin F.1, ngase i dëmtuari F., ishte i shtrirë. E din që dikush ka rënë në tokë nga pjesa në drejtim të kioskës kah gjendej i ndjeri F.1 dhe i pandehuri B.. Pas kësaj, i akuzuari R. është ofruar dhe nga afërsia ka shtënë në drejtim të atij personi që ka qenë i shtrirë dhe më vonë e ka kuptuar se ka qenë i ndjeri F.1 dhe pas këtij momenti, i akuzuari R. ka ardhur në drejtimin e të dëmtuarit F. së bashku me të akuzuarin F., me ç'rast i akuzuari R. ka tentuar që të shkrep për së afërmi në drejtimin e të dëmtuarit F., mirëpo nuk i ka funksionu revolva edhe pse ka provuar tri herë. Pastaj, i akuzuari F. ka thënë ik të akuzuarit R. dhe të njëjtit kanë ikur në drejtim të shtëpisë së tyre.

Pas largimit të të akuzuarve F. dhe R. nga vendi i ngjarjes, ka dalë daja i të dëmtuarit, A. Xh. ku të njëjtit i ka treguar se është i plagosur, ku fillimisht i dëmtuari F. kishte menduar është plagosur në këmbë. I njëjti e ka kapur të dëmtuarin F. dhe e ka ngritur në pozitën pak sa më lartë, ndërsa pas kësaj, A. Xh. ka shkuar te të ndjerët F.1 dhe A. për t'i dhënë ndihmë. Të dëmtuarin F.in e kanë dërguar së pari në Emergjencën e Gjilanit, ndërsa më pastaj edhe në Prishtinë me autoambullantë. Në Prishtinë ka qëndruar dy javë dhe nuk e dinë nëse nga trupi i tij, kanë hequr ndonjë predhë, sepse ka qenë në anestezion. Në trupin e të dëmtuarit gjendet vetëm një vrimë në pjesën e djathtë të gjoksit nën qafë dhe mjekët të dëmtuarit F. i kanë treguar se nga trupi i tij i kanë nxjerrë dy predha. Revolet të cilat i kanë përdorë F., B. dhe R. kanë qenë në gjendje gatishmërie, ngase nuk e kam vërejtur se të njëjtit i kanë raportit më herët. Në momentin kur i akuzuari F. shtënë në drejtim të A., A. nuk ka pasur diçka në dorë në vete. Prej ditës që ka ndodh ky rast, i dëmtuari F. prej pjesës së gjoksit është i palëvizshëm dhe për tu shëruar ka qenë edhe në Tajlandë, ku e ka bërë një trajtim eksperiment

me qeliza. Natën kritike, i dëmtuari F. ka mundur t'i identifikoj figurat edhe pse ishte errësirë edhe pse ishte i shtrirë, ngase ndriqimi ka qenë i mjaftueshëm.

Vendi ku ka qenë i shtrirë i dëmtuari F. L., vendi ku ka qenë i shtrirë axha i tij – ndjeri A. L. dhe vendi ku ka qenë i shtrirë babai i tij – i ndjeri F. L., janë paraqitur në skicën nr.14 të cilën e ka plotësuar i dëmtuari F. L.. Nga kjo skicë, shihet se i ndjeri A. L., ka qenë i shtrirë kah mesi i rrugës, por ka pjesa që shkon më afër pllacit të R. M., afër skajit të këtij pllaci, i dëmtuari F. L., ka qenë afër të ndjerit A. L., kah drejtimi i parkut, ndërsa i ndjeri F. L., ka qenë në mes të rrugës e cila gjendet në mes të pllacit të R. M.dhe N. së B..

I dëmtuari F., nuk ka ditur se si ta shpjegojë faktin se predhat janë nga një armë, është fjala për predhat që janë nxjerr trupi i tij, nga trupi i A. it dhe nga trupi i të ndjerit F.1.

2.2. Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1. Dëshmitari A. Xh., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor¹⁰ ka deklaruar se natën kritike ka shkuar si musafir te dhëndëri i tij – i ndjeri F.1. Në shtëpi përveç dhëndërit të tij, kishin qenë edhe motra e tij – V., së bashku me fëmijët e saj, F. dhe T.. Aty kishin biseduar për gjëra të zakonshme dhe jetës së përditshme. Pas një kohe, i ndjeri F.1, është ngritur dhe ka dalë në oborr të shtëpisë dhe së bashku me të, ka dalë edhe F.. Gjatë kësaj kohe, dëshmitari A. Xh., ka qëndruar brenda së bashku me motrën e tij – V., ku pas 5-10 minutave, ka dalur në oborrin e shtëpisë edhe vetë dëshmitari A. Xh., i cili e kishte parë të ndjerin A., të akuzuarin F.M., të ndjerin F. L. së bashku me djA.n e tij F., të cilët kishin qenë duke biseduar në oborrin e shtëpisë. Gjatë kësaj bisede, dëshmitari A. Xh., kishte dëgjuar të ndjerin F.1 duke thënë këto fjalë: “se nuk është nevoja me hjek trafikën, duhet mu qel rruga”, ndërsa i akuzuari F.M. thonte: “se unë kam ardhur me zgjidh problemin”. Pas pak minuta është hapur dera e oborrit ku e ka parë të akuzuarin R. M., me një sakicë në dorë, ku në këto momente të gjithë kanë dalur jashta oborrit të shtëpisë, ndërsa dëshmitari A. Xh., ka mbetur te dera e oborrit afër skajit të ndërtesës. Sulmin i pari e ka filluar i akuzuari R. M., i cili në fillim është drejtuar kah F. L., ndërsa F.1 ka dashur që të mbrohet dhe ka dashur që t'ia kap sopatën të akuzuarit R. M. kur e ka parë të njëjtin, mirëpo nuk ka mundur që ta vërejë nëse F.1 ka arritur që t'ia tërheq sopatën nga dora të akuzuarit R. M.. Mandej, i njëjti ka dëgjuar disa krisma të cilat kanë qenë krisma nga armë të ndryshme, ku pas një minuti apo dy minutave (edhe pse nuk ka qenë i sigurt se sa ka zgjat kjo ngjarje) është qetësuar situata. Krismat e armëve kanë

¹⁰ Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 340 paragrafi 1 të KPP, si dhe duke u bazuar në faktin se dëshmitari A. Xh. është në lidhje familjare, si me të akuzuarit F. dhe R. M. (të akuzuarin F. e ka dajë, ndërsa të akuzuarin R. e ka djalë të dajës), ashtu edhe me të dëmtuarit (I ndjeri F. L., ka qenë dhëndër i tij, përkatësisht bashkëshorti i motrës së tij; të dëmtuarit F. dhe A. L., i ka djem të motrës), para marrjes së tij në pyetje, ka kërkuar nga ai dhënien e betimit.

qenë të ngadalshme dhe nuk kanë qenë refall, ndërsa nuk i ka parë personat që kanë shtënë me armë. Pas kësaj, i njëjti ka vrapuar për ta shikuar se çka po ndodh, ku e ka parë të ndjerin A. të shtrirë në tokë, ndërsa F. kishte qenë mbi trupin e A. çka do të thotë se A. ka qenë nën F.. Në atë moment, dëshmitari e ka prekur pulsën e A. dhe të njëjtit i ka bërë një reanimim, mirëpo e kishte parë se i njëjti kishte vdekur. Pas kësaj i dëmtuari F. i ka thënë dëshmitarit se: “dajë jam i plagosur dhe frymarrja po më ndërprehet”, ku dëshmitari e kishte marrë të dëmtuarin F. dhe e kishte mbështetur te ndërtesa që është pronë e tyre afër garazhës. Mandaj e kishte kthyer kokën dhe e kishte parë F.1 i cili kishte qenë diku larg 5-6 metra i shtrirë për toke dhe të njëjtit ia ka ofruar ndihmën, ngase i njëjti vetëdije nuk kishte patur mirëpo, kishte shenja jete, ngase kishte rrahje të pulsit të zemrës. Edhe F.1 i ka dhënë frymarrje dhe e ka shtypur në gjoks. Pas kësaj dëshmitari e ka ftuar policinë dhe kolegët e tij të ndihmës së shpejtë, të cilët kanë ardhur shumë shpejt. Dy të ndjerët F.1 dhe A. me automjetin e ndihmës së shpejt janë dërguar në Emergjencë, ndërsa të dëmtuarin F. në Emergjencë, e kishte dërguar një fqinjë i tij. Pasi që ka arritur në Emergjencë, aty e kishte parë se kishte qenë edhe A. i cili ishte qenë i plagosur. Pas kësaj, mjekët e kishin njoftuar dëshmitarin se A. dhe F.1 kanë vdekur, ndërsa F. dhe A. i duhet të transferohen në Prishtinë. Pas transferimit të dëmtuarve F. dhe A. për në Prishtinë, dëshmitari A. Xh., ka shkuar te shtëpia e të ndjerëve, ku i njëjti personA.sht i ka dhënë ineksion për qetësim motrës së tij V. dhe bashkëshortes së të nderit A.. Mandej, dëshmitari ka vazhduar rrugën për në Prishtinë për ta parë gjendjen e A. dhe F., të cilët kishin qenë tek salla ku i vendosin personat që janë në gjendje të rëndë shëndetësore. Diku pas 3-4 orëve, të njëjtit janë nxjerrë nga kjo sallë, mirëpo nuk kanë mundur të komunikojmë me ta, për shkak se të njëjtit kishin të vendosur aparatin e frymarrjes. Pas kësaj dëshmitari ka qenë shumë i angazhuar edhe me familjarët e tij-nënë të tij, ngase e njëjta është motër e të akuzuarit F., por gjithashtu edhe me familjarët e të ndjerëve A. dhe F. L.. Pasi është përmirësuar gjendjalishëndetësore e A., dëshmitari A. Xh., ka biseduar me të për rastin që ka ndodhur dhe nga ai është njoftuar se përveç të akuzuarve F. dhe R. M., në vendin e ngjarjes kanë qenë edhe të akuzuarit B. B. dhe B. Sh., që të dy nga K., të cilët persona edhe vetë dëshmitari i kishte parë në vendin e ngjarjes. Mirëpo, meqë ka qenë terr, dëshmitari nuk ka mundur t’i shohë nëse këta persona janë përfshirë në përleshje.

Dëshmitari A. Xh., ka sqaruar se rrahjen i pari e ka filluar R., cili e ka sulmuar vetëm F.1, mirëpo paraprakisht i kishte fyer të nderit F.1 dhe A.. Dhe sa i përket sulmit që e ka bërë i akuzuari R. i njëjti ka ndodhur te kapaxhiki i shtëpisë e jo te dyert e shtëpisë.

Dëshmitari nuk e ka ditur nëse paraprakisht të akuzuarit dhe të dëmtuarit kanë patur ndonjë problem, ngase të akuzuarit i ka dajë (F. dhe R.) ndërsa të dëmtuarit A. dhe F. nipa dhe sigurisht do të intervenonte për ta zgjidh problemin, problem ky që ka ndodhur për shkak të rrugës.

Sa i përket dëshmitarit I. L., dëshmitari A. Xh., ka deklaruar se të njëjtin e ka parë që ka ardhur në vendin e ngjarjes pasi që kishin ardhur policia.

Sa i përket gjendjes shëndetësore të dëmtuarit F.L., dëshmitari A. Xh., ka deklaruar se për shkak të profesionit tij, ai është duke u kujdesur për F., gjendjalishëndetësore e të cilit është e rëndë, përkatësisht 95% e trupit të tij është e palëvizshme. Vetëm pjesa e epërme e trupit të tij nga gjoksi është e lëvizshme dhe i njëjti vazhdimisht ka nevojë për përkujdesjen e një personi tjetër. Në fundi, dëshmitari A. Xh., ka shtuar A. i ka thënë se i akuzuari R. e ka goditur me armë F., mirëpo nuk e ditur se a i ka thënë kështu F. apo e ka parë vet A..

2.2.2. Dëshmitari Sh. Xh., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka treguar se si natën kritike rreth orës 23:45 minuta, e kishte ftuar në telefon i akuzuari F.M., duke kërkuar nga dëshmitari që të vijë në Gj., mirëpo duke mos ia treguar arsyen. Dëshmitari Sh. Xh., kishte dalur në rrugë për ta pritur të akuzuarin F.M., mirëpo i njëjti nuk kishte ardhur. Pas kësaj dëshmitari ishte kthyer në shtëpinë e tij dhe tentuar që ta kontakojë përmes telefonit të akuzuarin F.M., mirëpo nuk kishte mund që të bisedojë me të, sepse e kishte të mbyllur telefonin, pas kësaj e kishte ftuar bashkëshortën e të akuzuarit – T. M., e cila i kishte thënë se “i akuzuari F. është nisur me të marrë ty dhe nuk më intereson më asgjë”. Mandej, dëshmitari Sh. Xh., ishte njoftuar nga djA. i tij – Përparimi, së ka ndodhur një tragjedi e madhe, me ç’rast janë vranë A. dhe F.1. Së bashku me djA.n e tij – P. kishin shkuar në Gj., te vendi i ngjarjes dhe aty kishin parë oficerët e Policisë së Kosovës, ndërsa me lejen e tyre, kishte shkuar edhe te shtëpia e vajzës së tij-V., përkatësisht, te shtëpia e të dëmtuarve. Rruga te vendi i ngjarjes kishte qenë e errët, mirëpo te hyrja e shtëpisë kishte patur dritë. Vazja e tij e kishte njoftuar dëshmitarin se natën kritike kishte dëgjuar disa krisma dhe kishte dëgjuar se janë vranë dy persona dhe dy të tjerë janë plagosur, se këto vrasje e plagosje i ka kryer i akuzuari F.M., me djA.n e tij dhe dy persona tjerë. Para ndodhjes së këtij rasti, raportet në mes të akuzuarve F.dhe R. M., në njërën anë dhe familjarëve të ish dhëndrit tij-F.1 kanë qenë të mira dhe kanë hyrë e dalë në mes veti.

2.2.3. Dëshmitari N. M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se natën kritike, diku rreth orës 23:50 minuta, derisa kishte qenë duke fjetur banesën e tij e cila gjendet afër vendit ngjarjes është njoftuar nga bashkëshortja e tij se e njëjta i kishte dëgjuar disa krisma të armëve, mirëpo dëshmitari nuk kishte besuar në këtë dhe bashkëshortës së tij i kishte thënë se ato janë krisma të fishekë-zjarrëve. Gjatë kohës kur i kishte dëgjuar këto krisma, bashkëshortja e tij kishte qenë duke i tharë disa tasha të cilat i kishte marrë nga makina e larjes së teshave. Pas pak, dëshmitarin e kishin njoftuar edhe fëmijët e tij, se dikush nga fqinjët po kërkon ndihmë dhe mandej dëshmitari kishte dalur në vendin e ngjarjes, ku aty kishte parë disa oficerë të Policisë së Kosovës, një infermiere dhe një nip apo dajë i të dëmtuarve.

Së pari në vendin e ngjarjes dëshmitari e kishte parë F.1n, i cili kishte qenë i shtrirë në shpindë me sy kah qielli diku 5-6 metra larg shkallëve të N. së B.. I njëjti kishte patur disi pak frymarrje dhe ishte në momentet e fundit të jetës. Është afruar dhe ka tentuar që t'i jap ndihmë të njëjtë dhe e ka parë se nën shpinën e tij rrjedhte gjak, si dhe shpina e tij ishte e nxehtë. Pas kësaj, dëshmitari kishte dëgjuar një zë “ndihmë axha N.” nga i dëmtuari F., dëshmitari kishte shkuar dhe ju kishte afruar, ku kishte parë se ai ishte mbi trupin e axhës së tij – A.. Dëshmitari me ndihmën e një infermiere e ka futur të dëmtuarin F. në veturën e tij dhe e ka dërguar në Emërgjencë në Gjilan. Gjatë rrugës, i dëmtuari F., kishte kërkuar nga dëshmitari që sa ma shpejt ta dërgojë në Emergjencë, ndërsa dëshmitari e kishte pyetur të njëjtin se “çka ka ndodhur, si rrjedhi ngjarja dhe nga kush”, kurse i dëmtuari F., ishte përgjigjur se “po e dina krejt”. Kur dëshmitari e kishte dërguar të dëmtuarin në Emergjencë në Gjilan, aty kishte kuptuar se kush me kënd është përleshur. Ay kishtin ardhur edhe familjarët e të dëmtuarve dhe motra e të ndjerëve A. dhe F. L., i kishte thënë dëshmitarit N. M. se “a po e shifni se çka na banën tanët dhe e njëjta e ka përmendur si vrasës F.”.

Në vendin e ngjarjes, dëshmitari N. M., nuk kishte parë ndonjë mjet-armë, ngase qëllimi i tij ka qenë që t'i ofrojë ndihmë personave. Në vendin e ngjarjes nuk ka patur dritë, mirëpo edhe pse ka qenë terr, dëshmitari ka mundur që të shoh për t'iu ofruar ndihmë të dëmtuarve.

2.2.4. Dëshmitari E. M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor¹¹ ka deklaruar se ditën kritike ka punuar në kioskë së bashku me me dëshmitarin R. E., prej orës 15:00 deri 23:00. Derisa i njëjti kishte punuar në kioskë natën kritike, nuk kishte shkuar i akuzuari F.M., ngase i njëjti atë ditë kishte qenë duke e rregulluar një veturë, ndërsa i akuzuari R. M., në kioskë kishte qenë rreth orës 17:30 kur e kishte marrë një pako cigare dhe ishte larguar. Gjithashtu, ka deklaruar se natën kritike në kioskë, kishte qenë edhe dëshmitari E. R. i cili e kishte blerë një birrë.

Dëshmitari E. M., siç kishte deklaruar gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit të shtetit, edhe në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se natën kritike diku rreth orës 19:00 kishte dëgjuar një zhurmë dhe kur kishte dalë jashtë kioskës kishte parë se Dr.E. R. duke kaluar rrugës afër kioskës kishte rrëzuar me këmbë një dru-krerë që ka qenë i vendosur në disa blloka afër kioskës. Përmes këtij kreni kanë qenë të vendosura edhe disa paleta të cilat i kishte vendosur pronari i banesës – i ndjeri F. L.. Natën kritike, diku rreth orës 20:00, kishte shkuar tek kioska i dëmtuari F.i, i cili e kishte pyetur dëshmitarin se kush e ka rrëzuar atë dru, ndërsa dëshmitari E. M., kishte deklaruar se nuk e ka parë se kush e ka rrëzuar. Arsyeja pse dëshmitari E. M. nuk i ka treguar F. që këto paleta i ka rrëzuar Dr.E., është se i njëjti nuk ka dashur të ketë problem me askënd.

¹¹ Trupi gjykues pas dëgjimit të prokurorit, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe mbrojtësve të akuzuarve, si dhe u bazuar në nenin 127 paragrafi 4 të KPP, ka marrë aktvendim me të cilin ka vendosur që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet E. M., edhe pse i njëjti është i moshës 17 vjeçare, ngase trupi gjykues vlerëson se i njëjti është i aftë, që ta kuptojë se i njëjti i nënshtrohet detyrimit për ta treguar të vërtetën.

Pas një kohe kur dëshmitari ka dalur jashtë kioskës, e kishte parë të ndjerin F.1 së bashkë me të dëmtuarin F., duke i rregulluar paletat. Së bashku me ta kishte qenë edhe një person, mirëpo dëshmitari nuk e kishte vërejtur se kush është ky person. Pas pak kohe, dëshmitari E. kishte dalur për t'i mbyllur frizat, mirëpo nuk kishte mundur që t'i mbyll, për shkak zinxhiri ishte i zënë me paleta dhe aty kishte ardhur i akuzuari R. i cili i kishte ndihmuar për t'i mbyllur frizat. Kur i akuzuari R. e kishte pyetur se kush i ka renditur këto paleta, atëherë ishin përgjigjur F.1 ose F., të cilët kishin qenë aty afër, duke thënë se ne i kemi vendosur, ku edhe kanë filluar që të fyhen me të akuzuarin R. mirëpo dy persona tjerë i kanë ndarë dhe nuk i kanë lejuar që të afrohen. Gjatë kësaj kohe, F.1 dhe F.i, kanë tentuar që ta sulmojnë të akuzuarin R. dhe gjithashtu ka patur reagim edhe nga i akuzuari R. mirëpo nuk kanë mundur që të afrohen. Pas kësaj, F.1, A. dhe F. kanë shkuar në drejtim të shtëpisë së tyre dhe gjithashtu edhe R. është nisur në drejtim të shtëpisë së tij. Natën kritike, i ndjeri F.1, me një sopatë i kishte rregulluar paletat, ndërsa me një palë dana e kishte rregulluar telin e paletave. Këtë sopatë, F.1 e kishte marrë te muri i çebaptores e cila ishte afër kioskës dhe atë në momentin kur djA. i tij F. kishte hyrë në konflikt me R., ndërsa F. e ka marrë sëpatën nën paletën ku qëndronte frigoriferi.

2.2.5. Dëshmitari A. K., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se natën kritike rreth orës 23:45 minuta, derisa ishte në banesën e tij e cila gjendet shumë afër vendit të ngjarjes kishte dëgjuar disa zhurma, mandej kishte dëgjuar edhe disa krisma të cilat ishin të armëve apo të fishekë-zjarreve të cilat nuk ishin “rafall”, përkatësisht ishin me ndërprerje. Pas kësaj, i njëjti është munduar që t'i qetësojë fëmijët e tij dhe pas pak kishte dëgjuar zërin e I. L., i cili kishte kërkuar që ta dërgojë të djA.n e tij – A. te mjeku. Pasi ka dal në vendin e ngjarjes kishte parë se aty ishin edhe ekipa mjekësore e ndihmës së shpejtë, si dhe e kishte parë të shtrirë në shpinë të ndjerin F.1 afër shkallëve të hyrjes së ndërtesës. Te F.1 kishte vërejtur gjakdërdhje të mëdha dhe gjithashtu e kishte parë edhe të ndjerin A., i cili kishte qenë tek hyrja e garazhës që është në ndërtim e sipër, e cila ka qenë pronë e të ndjerëve. Edhe i ndjeri A. kishte qenë i përgjakur në pjesën e stomakut. Dëshmitari A. K. së bashku me dëshmitarin A. Xh. kanë hyrë në pjesën e mbrapme të automjetit të ndihmës së shpejt ku ishin futur të ndjerët dhe më pastaj të njëjtët janë dërguar në Emërgjencë në Gjilan. Në vendin e ngjarës, dëshmitari A. K. e kishte parë dëshmitarin N. M., i cili me veturën e tij e kishte dërguar të dëmtuarin F. në Emërgjencë.

Kur dëshmitari A. K., kishte shkuar për të shprehur ngushëllime, babai i të ndjerëve I. L., e kishte njoftuar dëshmitarin se “të ndjerët A. dhe F. L. i ka vrrarë F.”.

2.2.6. Dëshmitarja T. M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor natën kritike paraprakisht kishte qenë tek kunata e saj, përkatësisht tek motra e bashkëshortit të saj-të akuzuarit F.M., i cili edhe kishte ardhur më vonë. Pas

kishte ngrënë darkë i akuzuari F.M., të njëjtin e kishte telefonuar i akuzuari R. M., ku më pastaj i akuzuari F.M., i ka thënë dëshmitares T. M., se F.1 paska dal me një sopatë te kioska. Pas kësaj, i akuzuari F.M. së bashku me dëshmitaren T. M. dhe nipin e tyre janë nisur me veturë për në shtëpinë e tyre. Pasi kanë arritur te shtëpia e tyre, dëshmitarja T. M., së bashku me nipin e saj kanë hyrë në shtëpi, ndërsa i akuzuari F.M., kishte kërkuar nga dëshmitarja që të provojë me telefonu të akuzuarin R. ndërsa vetë i akuzuari F.dajën e tij, për t'i thënë se po vi me të mar me veturë në shtëpi sepse me F.1 nuk është puna mirë. Pas një kohe, dëshmitarën e kishte njoftuar nipi i saj se “pat krisma, po gjuajnë bombica”, ndërsa pas disa minutave kishin ardhur disa zyrtarë policor, të cilët e kishin njoftuar dëshmitarën se janë vrarë dy persona dhe dy persona tjerë janë plagosur. Gjithashtu, ja kanë treguar edhe emrat e këtyre personave të vrarë dhe të plagosur, si dhe e kishin njoftuar se bashkshorti i juaj i ka vrarë këta persona. Mandej, zyrtarët policor kanë kërkuar nga dëshmitarja që ta dërgojnë në një vend tjetër dhe nuk e kanë lejuar që të qëndrojë në shtëpi.

Dëshmitarja gjithashtu ka shtuar se raportet në mes familjes tyre dhe familjes së të ndjerëve-të dëmtuarve kanë qenë shumë të mira dhe të njëjtit i ka llogaritur si fëmijët e saj. Nga momenti kur ka ndodhur kjo ngjarje, dëshmitarja në shtëpinë saj nuk ka jetuar më, për shkak të sigurisë dhe ka shkuar të jetojë nëpër të afërm të bashkëshortit saj dhe të familjes saj dhe të të gjitha këto familje ku ka qëndruar janë kërcënuar dhe momentA.sht për shkak të nipit, e njejta jeton në P.. E njejta ka deklaruar se i është djegur dy herë shtëpia e saj dhe ajo e dinë se kush ja ka djegur shtëpinë.

2.2.7. Dëshmitari R. E., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se natën kritike tek kioska e të akuzuarit F.M., ka punuar deri në ora 23:00, ndërsa diku rreth orës 22:00 deri në 22:30 minuta, afër kioskës kishin qenë i ndjeri F.1 së bashku me dy djemtë e tij, të cilin i kanë rregulluar dhe shtrënguar disa paleta. F.1 së bashku me dëshmitarin E. i kanë ndihmuar dëshmitarin R. për t'i lidhur zinxhirët e frigoriferëve të kioskës. Pas kësaj, dëshmitari R. E., ka shtuar se është zhvilluar një mosmarrëveshje në mes të ndjerit F.1 dhe të akuzuarit R., ku i ndjeri A. së bashku me djemtë e F.1 kanë ndërhyrë dhe situata është qetësuar. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se arsyeja e kësaj mosmarrëveshje mund të ketë qenë vendosja e disa paletave nga të dëmtuarit. Pas kësaj mosmarrëveshje, dëshmitari nuk e ka ditur se ku kanë shkuar personat që ishin të involvuar në këtë mosmarrëveshje. Pasi që e ka mbyllur kioskën, dëshmitari me biçikletë ka shkuar në shtëpinë e tij dhe të nesërmën në treg kishte dëgjuar për ngjarjen tragjike që kishte ndodhur.

2.2.8. Dëshmitari E. R., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka treguar për raportet që i njëjti ka patur para dhe pas ngjarjes kritike me të akuzuarit F.dhe R. M., si dhe me të dëmtuarit. Gjithashtu, ai ka rrëfyer edhe për çështjen e paletave të cilat kanë qenë të vendosura afër kioskës. I njëjti ka

deklaruar se para ngjarjes kritike raportet e tij me të akuzuarit F.dhe R. M., kanë qenë të mira dhe shoqërore, ngase barnatorja e dëshmitarit ka qenë afër kioskës së të akuzuarit F.M.. Gjithashtu, edhe raportet e tij me të ndjerët A. dhe F. L., ka qenë të mira dhe të njëjtit kanë blerë barna në barnatoren e dëshmitarit.

Dëshmitari E. R., e ka mohuar faktin se natën kritike ai t'i ketë rrëzuar paletat që kanë qenë të vendosura afër kioskës së të akuzuarit F.M. dhe nuk e ka ditur se kush i ka vendosur këto paleta, sepse edhe ashtu rrugën në të cilën kanë qenë të vendosura këto paleta nuk e ka shfrytëzuar.

Natën kritike, dëshmitari E. R., në barnatorën e tij ka punuar deri në ora 20:00 dhe deri në këtë kohë nuk ka ndëgjuar ndonjë zhurmë apo diçka të pazakontë. Disa ditë pas ndodhjes së këtij rasti, i dëmtuari A. L. ka shkuar te barnatorja e tij dhe e ka sulmuar dëshmitarin me pretekst se i njëjti ka deklaruar rrejshëm në polici.

2.2.9. Dëshmitari B. B., o. i P. së K., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se derisa ishte në detyrë zyrtare natën kritike e kishte marrë një informatë nga baza se në rrugën “...” në Gj., ka të shtëna me armë zjarri, ku pas kësaj menjëherë janë nisur për në vendin e ngjarjes. Kur kanë arritur në vendin e ngjarjes, afër kioskës, e kanë takuar një grua të moshuar, për të cilën më vonë kanë mësuar se ishte nëna e të ndjerëve, e cila bërtiste dhe kërkonte ndihmë. Gjithashtu, kanë takuar edhe një person të moshuar i cili bërtiste se “F.C. mi vrau djemtë”. Të njëjtit kanë vrapur në drejtim të lokacionit dhe armët e tyre i kanë patur në gjendje të gatishmërisë, ngase ishte errësirë dhe e kishin vetëm një bateri. Rrugës kanë parë një person të shtrirë, i cili nuk mund të fliste dhe kishte gjakderdhje, të cilit janë munduar që t'i japin ndihmë. Duke e parë person, e kanë njoftuar bazën në mënyrë që të njoftohet edhe ndihma e shpejtë. Pas kësaj ka dëgjuar edhe britmë, ku edhe kanë vrapuar në atë drejtim, me ç'rast te objekti në ndërtim e sipër, afër garazhës kanë parë edhe dy persona.

Dëshmitari B. B., në skicën nr.17, më saktësisht e ka paraqitur vendin se ku kanë qenë këta dy persona. Prej këtyre dy personave, njëri ka qenë i vdekur, ndërsa tjetri ka patur shenja jete. Në vendin e ngjarjes, përveç atij personit të moshuar dhe nënës të ndjerëve, ka qenë edhe një i afërm i të dëmtuarve dhe disa gra. Në vendin e ngjarjes, pas pak kanë ardhur edhe disa patrulla tjera të policisë dhe ndihma e shpejtë. Dëshmitari në vendin e ngjarjes ka parë njolla gjaku dhe atë afër viktimave, një drapër për korrjen e misrit, një sëpatë, një revole, si dhe gëzhoja të revoles. Revolja e lartcekur ka qenë afër objektit në ndërtim e sipër dhe ka qenë afër dy personave të shtrirë. Pozitën e këtyre dy personave të lënduar dhe e armës është prezentuar në skicën nr.19 nga ana e dëshmitarit B. B.. Nga kjo shihet se këta dy persona kanë qenë afër njëri-tjetrit, afër objektit që është në ndërtim e sipër dhe gjithashtu, afër tyre ka qenë edhe revolja.

Pas kësaj, së bashku me disa zyrtarë tjerë policor janë nisur në drejtim të shtëpisë së të akuzuarve dhe aty e kemi takuar bashkëshorten e të akuzuarit F.M. me një djalë të vogël. Pasi e kanë kontrolluar shtëpinë dhe objektet përcjellëse e

kanë njoftuar bashkëshorten e të akuzuarit F.M. për rastin e ndodhur, ngase e njëjta nuk kishte qenë në dijëni se çka ka ndodhur. Tek kjo shtëpi kanë qëndruar për shkaqe të sigurisë edhe dy orë dhe pas kësaj bashkëshorten e të akuzuarit F.së bashku me djA.n e vogël i kanë dërguar në një lokacion tjetër. Sa i përket ndriqimit, dëshmitari ka deklaruar dritë ka patur te shtëpia e të lënduarve dhe te blloku banesor-ndërtesa e bardhë.

2.2.10. Dëshmitari S. R., oficer i P. së K., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se natën kritike ka qenë në vendin e ngjarjes dhe detyrë e tij ka qenë kqyrja dhe hetimi i vendit të ngjarjes. Vendi i ngjarjes është fotografuar, ndërsa kontrollimi i vendit të ngjarjes është bërë me metodën rrjetore, ku janë gjetur dëshmitë të cilat janë përshkruar në raportin e vendit të ngjarjes dhe në shkresat tjera. Arma dhe gjëzhojat të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes janë dërguar për ekzaminim bA.stik, ndërsa pas ekzaminimit të bërë, ka rezultuar se në këtë armë nuk janë gjetur gjurmë të gishtërinjëve, e as nuk është gjetur gjak apo diçka tjetër. Duke u bazuar në këtë i njëjti nuk ka qenë në gjendje që të përcaktoj se kush e ka përdorur këtë armë. Pas autopsisë së bërë, dëshmitari i ka marrë dy predha të cilat janë nxjerr nga trupi i të ndjerit F. L., si dhe e ka marrë një predhë e cila është nxjerrë nga trupi i të lënduarit A. L., ku të njëjtat janë dorëzuar për ekzaminim. Përveç këtyre predhave, hetuesit kanë marrë edhe një predhë e cila është nxjerrë nga trupi i të lënduarit F. L. dhe gjithashtu edhe kjo predhë është dërguar në ekzaminim. Pra, përveç këtyre katër predhave të lartcekura të nxjerra dy nga trupi i të ndjerit F.L., një nga trupi i të lënduarit A. L. dhe një nga trupi i F. L. predha tjera nuk kanë gjetur.

2.2.11. Dëshmitari I. L.,¹² gjatë dhënies së deklaratës në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka deklaruar se në vendin e ngjarjes nuk ka qenë kur ka ndodhur ngjarja, mirëpo aty ka shkuar kah ora 00:00 minuta, pasi që veç e kishte thirrë në telefon, bashkëshortja e të ndjerit F.1– V.. Kur ka arritur në vendin e ngjarjes, aty në rrugë e ka parë të shtrirë F.1., i cili ishte i përgjakur, kishte plagë në kokë dhe në gjoks, të cilin e ka thirrë "F.", mirëpo i njëjti nuk ka mundur që të përgjigjet. Gjithashtu, në vendin e ngjarjes, e ka parë edhe A., të shtrirë në tokë, i cili ishte i vdekur dhe mbi të ishte edhe F..

¹² Dëshmitarit I. L., i është dorëzuar ftesa për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, mirëpo nuk ka prezentuar në shqyrtim gjyqësor, ngase sipas informatave të siguruar nga i dëmtuari A. L., i njëjti gjendet në A.. Për të vërtetuar këtë fakt, ndaj dëshmitarit I. L., është lëshuar udhër për sjellje dhe nga konstatimi i Policisë së Kosovës, i datës 04.11.2014, shihet se me të vërtetë i njëjti ndodhet në A... Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe duke u bazuar në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, ka marrë aktvendim me të cilin ka vendosur që të lexohet deklarata e dëshmitarit I. L., e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 13.01.2014, ngase trupi gjykues ka vlerësuar se ardhja e tij në gjykatë, ka qenë dukshëm e vështirësuar, sepse sipas konstatimit të Policisë së Kosovës, i njëjti gjendet në A.. Në nenin 123 paragrafi 3 fjalia e fundit të KPP, është parashikuar “Deklarata në procedurë paraprake, mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit”.

Në vendin e ngjarjes, i kishte parë edhe dëshmitarët A. K. dhe A. Xh., të cilët i ndihmojshin personave të tjetër, për t'i futur të ndjerët në veturë.

Dëshmitari kishte deklaruar se raportet në mes të dëmtuarve dhe të akuzuarve F.dhe R. M., para ndodhjes së këtij rasti, kanë qenë të mira, për shkak të lidhjeve familjarëve. Se i njëjti, diku tri javë para datës kritike, së bashku me F.1 dhe një punëtor, kishin prerë një dru me degë që gjendej në pronën e Ibrahim Lipovicës (babai i të ndjerëve F.1 dhe A. L.), për shkak se i njëjti pengonte kamionat për të sjellur material ndërtimor dhe të nesërmen e ka takuar i akuzuari F., të cilit i kishte thënë se “daja I. e keni pre atë dru se unë një ditë do të vi me kriminallat”, ndërsa dëshmitari ishte shprehur me fjalët “nanën e nanës”, por se ka fyer të akuzuarin F., por ata “kriminal”.

Natën kritike dëshmitari I. L., kishte qenë te F.1, ku kishte ngrënë darkë dhe meqë nuk kishte limon për të pirë qaj, F. kishte shkuar për të blerë dhe kishte vërejtur se disa paleta ishin të rrëzuara, pastaj nga punëtorët e një qebaptore kishte kuptuar se i kishte rrëzuar farmacisti E. R. dhe i njëjti kishte sharë. Dëshmitari së bashku me A. kanë pirë qaj, ndërsa F.1 me F., kanë dalur dhe me një palë dana i kanë rregulluar paletat, pastaj ata janë kthyer diku pas orës 22:45 minuta. Pas kësaj, dëshmitari është dalur për të shkuar te banesa e tij dhe deri te kioska e të akuzuarit F., e kanë përcjellur F.1, F.i dhe A..

2.3. Deklarimet e ekspertëve

2.3.1. Eksperti mjeko-ligjor, Dr.Arsim Gërxhaliu, mendimin dhe konstatimin e tij lidhur me vdekjen e të ndjerëve F.1 dhe A. L. e ka paraqitur në formë të shkruar dhe gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dhënë sqarime më të hollësishme lidhur me këto çështje.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor i njëjti ka shtuar se i ndjeri F. L. ka pësuar gjashtë dëmtime, siç është cekur edhe në Raportin e Autopsisë Preliminare.¹³ Lëndimi në pikën I të RAP, ka një vrimë hyrëse e cila ndodhet në anën e djathtë të epërme të kafkës në vijë të drejtë mbi laprën e epërme të veshit të djathtë dhe gjatë rrugëtimit të saj predha ka goditur tri pika rezistente (pjesë kockore) dhe kjo plagë nuk ka vrimë dalëse. Lëndimi i paraqitur në pikën II të RAP ka vrimën hyrëse në drejtimin nga lartë poshtë duke u bazuar në pozitën anatomike dhe kjo predhë gjithashtu nuk ka dalë jashtë çka do të thotë se ka mbetur nën lëkurë në nivelin e ijes së majtë.¹⁴ Në këtë vend lëkura është e për ngjyruar me ngjyrë blu dhe ka gjak mbledhje nën lëkurore e cila është shkaktuar nga humbja e energjisë kinetike të predhës. Duke marrë parasysh lëndimin nr.1 dhe faktin se vendi i ngjarjes është i rrafshët dhe bazuar nga lëndimi i pikës nr.1 se kemi atakimin e organit vital të trurit dhe trupi ka filluar të bie, atëherë lëndimi

¹³ Raporti i Autopsisë Preliminare, në tekstin e mëtejshëm do të paraqitet në shkurtesën RAP.

¹⁴ Kjo plagë mund të shihet më për së afërmi në fotografitë nr.23, 24, 33 dhe 34.

nr.2 është marrë gjatë krrysjes-rënies së trupit. Andaj edhe ka konkluduar se lëndimi parë për kah koha është lëndimi nr.1, i cili është pasuar me lëndimin nr.2. Sa i përket lëndimit sipas pikës 3 të RAP, plaga është shkaktuar nga mjeti që posedon maje dhe teh, si dhe është në afërsi prej 1 cm nga lëndimi sipas pikës nr.2 e cila ndodhet në pjesën e mesme të majtë të gjoksit. Kjo plagë ka mundur të jetë e thellë 2-3 cm nga sipërfaqja e jashtme, ndërsa mushkëria ka mundur të prehet në një sipërfaqe prej 2 cm. Lëndimi sipas pikës 4 të RAP është shkaktuar nga arma e zjarrit, ku vrima hyrëse ndodhet në pjesën e përparme të epërme të krahut të majtë dhe shkon te poshtë duke dalë në pjesën e epërme të bërrylit të majtë.¹⁵ Edhe kjo plagë është shkaktuar gjatë kohës kur trupi ka qenë në pozicionin e rënies dhe kjo plagë është shkaktuar nga një predhë e veçantë, e treta me radhë. Meqë bëhet fjalë për pjesë lëvizëse të trupit atëherë ky lëndim është shkaktuar në afërsi kohore të afërt me lëndimin trupor sipas pikës 2, 4 dhe 5 çka do të thotë se janë shkaktuar gjatë rënies së trupit.

Sa i përket kohës së shkaktimit të këtyre lëndimeve, Dr.Arsim Gërxhaliu ka sqaruar se plagët me nr.2, 4 dhe 5 janë shkaktuar pas plagës nr.1, ndërsa sa i përket plagës nr.3, i njëjti beson se kjo plagë është shkaktuar para dëmtimeve të përshkruara nën numrat 1, 2, 4 dhe 5. Lëndimi sipas pikës nr.5 të RAP është një plagë tangjentore pasi nuk ka vrimë hyrëse dhe dalëse, si dhe e njëjta ndodhet në sipërfaqen e brendshme të krahut të majtë.¹⁶ Kjo plagë është shkaktuar me një predhë të veçantë të armës së zjarrit. Sa i përket plagës sipas pikës 6 të RAP bëhet fjalë për një gërvishtje sipërfaqësore e cila ka mundur të shkaktohet gjatë transportimit të viktimës.

Sa i përket shkakut të vdekjes së të ndjerit F. L., eksperti mjeko-ligjor ka deklaruar se dëmtimi i përshkruar në pikën nr.1 është shkaktar i vdekjes, pra kjo është plaga e cila ka sjellë vdekjen, ndërsa lëndimi nr.3, është lëndim i shkallës së rëndë, por 90% e njerëzve mbijetojnë nëse dërgohen shpejtë në spital. Me fjalë tjera 90% e njerëzve vetëm sa i përket lëndimit nën pikën 3 dhe sikur të mos ekzistonte lëndimi sipas pikës 1, do të mbijetojnë, ndërsa 10% nuk do të jetojnë.

Sa i përket pozitës së viktimës në momentin kur është goditur me mjetin mprehtës i cili e ka shkaktuar lëndimin nr.3, eksperti mjeko-ligjor, ka besuar se i ndjeri F.1 në momentin e goditjes ka mundur më tepër të jetë në këmbë, megjithatë nuk i ka përjashtuar edhe pozitë tjera.

Sa i përket RAP, të ndjerit A. L., eksperti mjeko-ligjor ka deklaruar se plaga nën pikën nr.1 është një plagë e cila është shkaktuar nga predha. Kjo plagë ka vrimën hyrëse dhe buzët e plagës janë të futura brenda në unazën vërejtëse, ku kjo plagë shkon në drejtim të thellësisë së kafazit të kraharorit dhe gjatë rrugëtimit të saj predha e dëmton zemrën, mushkërinë, etj.. Pra, drejtimi i predhës është nga e majta në të djathtë dhe nga lartë shumë lehtë poshtë dhe kjo plagë është plaga fatale, si dhe tej shpuese, çka do të thotë se kemi vrimën hyrëse dhe dalëse, kështu që edhe nuk ka predhë në brendësi të organizmit. Meqë predha ka

¹⁵ Kjo plagë mund të shihet në fotot nr.21 dhe 22.

¹⁶ Kjo plagë mund të shihet në fotografinë nr.36.

ardhur nga para majtas në drejtim pas djathtas dhe lehtë poshtë, pozicioni i të ndjerit ka qenë lehtësisht i kërrysur.¹⁷ Sa i përket lëndimit sipas pikës 2 të RAP, i njëjti është shkaktuar me mjet i cili ka maje dhe tehe dhe i njëjti nuk ka depërtuar në hapësirën e kafazit të kraharorit.¹⁸ Sa i përket kohës së shkaktimit të këtyre dy lëndimeve, eksperti mjeko-ligjor ka deklaruar se lëndimi sipas pikës nr.2, i ka paraprirë lëndimit nr.1.

Lëndimi sipas pikës nr.3, është shkaktuar me mjet i cili posedon maje dhe tehe dhe ky lëndim është plagë me buzë të rregullta, këndin e poshtëm të rregullt, këndin e epërm në zgjatimin në formë bishti, kurse në anën tjetër ekzistojnë dy zgjatime të vogla, të cilat janë të ndërprera dhe të njëjtat na bëjnë me dije se i njëjti ka rezistuar në mbrojtje.¹⁹ Ky lëndim është shkaktuar gjatë fazës së rezistencës para lëndimit nr.1, i cili lëndim ka qenë fatal, sepse lëndimi nr.1 ka atakuar organin super vital zemrën.

Sa i përket lëndimit nr.4 është një plagë prerëse e përmasave 20 x 2 mm, ku në pjesën e epërme është pak sa më e thellë e që shkon deri te kafa maksimum deri në 6 mm.²⁰ Edhe kjo plagë është shkaktuar gjatë rezistencës-përleshjes por para lëndimit nr.1.

Lëndimi nr.5 është një lëndim sipërfaqësor nën bërrylin e majtë. Ky lëndim është shkaktuar me një mjet i cili ka vetëm maje ose mund të jetë shkaktuar në ndonjë pjesë që nuk ka maje.

Shkaktari i vdekjes së të ndjerit A. L. është lëndimi nr.1 dhe sikur të mos ekzistonte ky lëndim atëherë nuk do të shkaktohej edhe vdekja e të ndjerit A. L..

Plagët në gjoks tek te dy autopsitë janë përafërsisht të njëjta dhe besojmë se të njëjtat janë shkaktuar me thika, ndërsa lëndimet në kokë nuk përjashtohet mundësia që janë shkaktuar nga ndonjë mjet tjetër.

Sipas ekspertit mjeko-ligjor, është jo shumë e besueshme që këto lëndime në kokë të kenë pasur mundësi të shkaktohen me sopatë, sepse sopata shkakton plagë qarëse.

2.3.2. Ekspertja Hidajete Muharremi, speciA.ste e lartë për serologji dhe ADN (Acidin Desoksiribonukleik), në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se sa i përket kësaj çështje penale në Agjensisë e Kosovës për Forenzikë²¹ ka pranuar këto dëshmi : D#8-sopatë; D#21-sopatë; D#18-thikë; D#20-thikë; D#13-drapër dhe D#23-thikë. Nga këto dëshmi janë nxjerrë mostrat e mundshme të ADN dhe atë :

- Nga dëshmia D#8 janë marrë këto mostra: D#8.a – mostra e mundshme e ADN e marrë prej skajeve të sopatës; D#8.d mostra e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku e marrë prej sopatës pjesa e fundit e bishtit të sopatës dhe

¹⁷ Kjo plagë mund të shihet në fotografinë nr.14.

¹⁸ Kjo plagë mund të shihet në fotografitë nr.14, 15 dhe 28.

¹⁹ Kjo plagë mund të shihet në fotografinë nr.26.

²⁰ Kjo plagë mund të shihet në fotografinë nr.25.

²¹ Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në tekstin e mëtejshëm do të paraqitet me shkurtesën AKF.

D#8.c mostra e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku e marrë prej sopatës (skajet e bishtit të sopatë dhe disa njolla të dukshme);

- Nga dëshmia D#21 janë marrë këto mostra: D#21.a Mostër e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku prej sopatës (skajeve dhe pjesa e bishtit të sopatës) dhe D#21.b Mostër e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku prej sopatës (skajet e pjesës së bishtit të sopatës);

- Nga dëshmia D#18 janë marrë këto mostra: D#18.a Mostër e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku prej thikës (skajeve të thikës).

- Nga dëshmia D#20 janë marrë këto mostra: D#20.a Mostër e mundshme e ADN e marr me tampon pambuku prej thikës (afër tehit të thikës); D#20.b Mostër e mundshme e ADN e marr me tampon pambuku prej thikës (pjesa e fundit e dorëzës dhe dy pjesët e rrumbullakt). E ka sqaruar se mostra D#20.a është marrë nga dorëza e thikës nga pjesa e cila gjendet afër tehit të thikës.

-Nga dëshmia D#13 janë marrë mostra të mundshme të ADN e marrë me tampon pambuku prej gjitha skajeve të draprit.

- Nga dëshmia D#23 janë marrë këto mostra: D#23 a. Mostër e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku prej thikës-skaji i dorëzës; D#23.a.1 Mostër e mundshme e ADN e marrë me tampon pambuku prej thikës (dorëza e thikës pjesa e mesit) dhe D#23.b Mostër e mundshme e ADN e marr me tampon pambuku prej thikës (pjesa e dorëzës së thikës afër tehit të thikës). Ekspertja Hidajete Muharremi, gjithashtu ka sqaruar se tek mostra D#23 b janë marrë dy tampona me gjak, ku njëra është shënuar “D#23.b”, ndërsa tjetra “D#23 b.”.

Gjithashtu, nga dëshmita D#23, janë marrë edhe këto mostra : D#23.c Mostër e mundshme e ADN e marr me tampon pambuku prej skajeve të tehit të thikës dhe D#23.d është një fije floku e marr nga teku i thikës pa rrënjë.

Përveç mostrave të lartcekura, në Agjencisë e Kosovës për Forenzikë janë sjellë për ekzaminim edhe mostrat standarde të gjakut dhe të fijeve të flokut të marra nga F.M., R. M. dhe B. B., si dhe mostrat standarde të gjakut të marra nga A. , F., A. dhe F. L., të gjitha këto janë të shënuara në faqen dytë të Raportit të ekspertizës, të datës 17.04.2014 dhe gjithashtu tek faqja e dytë janë cekur edhe metodat dhe pajisjet e përdorura. Ndërsa, në faqen e tretë të Raportit të ekspertizës, gjendet tabela në të cilën janë shënuar rezultatet e ekspertimit.

Pas ekspertimit të bërë konstatimi dhe mendimi përfundimtar është nga mostra D#20.a (dëshmia thikë) është fituar një profil i ADN i cili përputhet me profilin F.M. (dëshmia D#15). Prandaj, F.M. nuk mund të përjashtohet si kontributor me këtë dëshmi me fjalë të tjera mostra e ADN që është marrë prej dorëzes së thikës përputhet me profilin e ADN. Pra, nuk ka gjasë që asnjë person në këtë botë ta ketë profilin e njejtë me atë të F.M.. Gjasa e paraqitjes së këtij profili me popullacion është: 1 në 5.7 bilion në individ.

Nga mostra D#23.b (dëshmia D#23 thikë) dhe mostra D#20.b (dëshmia te thikë D#20) është fituar një profil i njëjtë i ADN i cili përputhet me profilin e R. M.t (dëshmia D#16) dhe R. M. nuk mund të përjashtohet si kontributor me këto dy dëshmi. Gjasa e paraqitjes së këtij profili me popullacion është: 1 në 1.78

biliard në individ. Nga mostra D#23b. (dëshmia D#23 thikë) është fituar një profil i pjesërishëm i përzier i ADN dhe F.M. nuk mund të përjashtohet si kontributor në këtë përzierje. Ekspertja ka sqaruar se nga dëshmia D#23.b është marrë mostër e mundshme e ADN me tampon pambuku prej dorëzes së thikës e cila gjendet afër tehut të thikës dhe me qenëse kishte gjak të mjaftueshëm këtu janë krijuar dy tampona njeri është emërtuar D#23.b dhe tjetri D#23b.

Nga mostra D#23.c e cila është marrë prej skajeve të tehut të thikës është fituar një profil i përzier i ADN i dy e më tepër personave i pa përshtatshëm për krahasim.

Nga mostra D#18.a, është fituar një profil i ADN i pjesërishëm dhe i përzier i papërshtatshëm për krahasim.

Nga mostra D#.a, D#21.a, D#20.b, D#13.a D#23.a.1 nuk është fituar profil i ADN për shkak të sasisë së pa mjaftueshme të ADN.

Nga mostra D#8.b, D#8.c dhe D#21.b nuk është identifikuar ADN me origjinë njerëzore.

Mostra D#23.d fije floku e marrë prej thikës pa rrënjë është e papërshtatshme për anA.zë të ADN dhe kjo fije floku ne nuk mund të ekzaminohet për shkak se e njëjta ka qenë pa rrënjë, ndërsa ne në laborator ekzaminimin e bëjmë vetëm në qoftëse fija e flokut është me rrënjë.

Të gjitha profilet e personave që kanë mundur të raportohen gjenden në raport dhe këto i referohen vetëm F.dhe R. M.. Ndërsa, për personat e quajtur B. B., A. , F., A. dhe F. L., ekspertja ka deklaruar se nuk mund të konkludoj se ka pasur profile të ADN të këtyre personave në dëshmitë e lartcekura.

Ekspertja Hidajete Muharremi, gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupit gjykues ja ka dorëzuar edhe dy fotografi të dëshmimeve D#8 dhe D#21, që janë dy sopata të ndryshme.

2.3.3. Eksperti Qëndrim Topalli, ekspert për armë të zjarrit dhe gjurmë të veglave në AKF, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar sa i përket kësaj çështje penale, hetuesit e Njësisë së Hetimeve dëshmitë i kanë sjellë të ndara në disa pjesë. Dëshmitë e para në AKF janë pranuar më datën 21.11.2013 dhe ato janë ekzaminuar dhe janë raportuar me datën 15.01.2014. Këto dëshmi që kanë të bëjnë me grupin e parë të dëshmimeve kanë qenë :

- 6 (gjashtë) gëzhoja të kalibrit... x ... mm dhe këto gëzhoja janë identifikuar si dëshmi me numra 6, 9, 11, 12, 17 dhe 24. Prej tyre 5 gëzhoja kanë qenë të stampuara “...” dhe një gëzhojë ka qenë ...;

- 1 (një) pistoletë e markës “...” m... e kalibrit... mm, me numër serik ... dhe kjo pistoletë ka qenë e evidentuar si dëshmia nr.19;

- 1 (një) gëzhojë pjesë e fishekut të kalibrit... mm, e cila ka qenë e stampuar 11-65 dhe kjo dëshmi është evidentuar me nr.19A;

- 1 (një) karikator të pistoletës së lartcekur me kapacitet prej 9 fishekëve dhe

- 8 (tetë) fishekë, të kalibrit... mm të stampuara Sa i përket numrit të fishekëve, eksperti Qendrim Topalli, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka sqaruar se gjatë hartimit të raportit të ekspertizës është bërë një lëshim dhe në te në vend se të shënohet 8 (tetë) fishekë janë shënuar 5 (pesë) fishekë.

Lidhur me grupin e parë të dëshmive, eksperti ka dhënë këtë konstatim dhe mendim përfundimtar:²²

1. Dëshmitë e dorëzuara 6, 9, 11, 12, 17 dhe 24 janë 6 gëzhoja pjesë e fishekëve të kalibrit... mm të cilat janë të gjuajtura nga e njëjta armë.
2. Dëshmitë e dorëzuara 14 janë një karikator me kapacitet prej 9 fishekëve të kalibrit... mm i cili është i dizajnuar tek pistoletat “...” ..., dhe 8 fishekë të kalibrit... mm.
3. Dëshmia e dorëzuar 19 është një pistoletë e markës “...” ... e kalibrit... mm, me numër serik ... dhe kjo armë është funksionale.
4. Dëshmia e dorëzuar 19.A është një gëzhojë pjesë e fishekut të kalibrit... mm, e cila është gjuajtur nga arma e cekur më lartë në dëshminë 19.

Në bazë të krahasimeve mikroskopike, arma nga dëshmia nr.19 dhe 6 gëzhoja sipas dëshmive 6, 9, 11, 12, 17 dhe 24, nuk përputhen me ndonjë rast nga libraria e rasteve të hapura në laboratorin e armës së zjarrit.

Dëshmitë nga grupi i dytë i dëshmive që janë dorëzuar në AKF për ekzaminim janë:²³

- 1 (një) pistoletë të markës “...” e kalibrit... mm, me numër serik “...” e cila është një verzion i pistoletës gjermane “...” dhe kjo armë është prodhuar në Francë.

- 1 (një) karikator me kapacitet prej 8 fishekëve të kalibrit... mm i cili është i dizajnuar për pistoletat “...” dhe

- 2 (dy) predha pjesë e fishekëve të kalibrit... mm, ku njëra prej tyre është e dëmtuar.

Sa i përket grupit të dy të dëshmive, eksperti Qendrim Topalli, ka deklaruar se dëshmitë e dorëzuara nr.25 janë dy predha pjesë e fishekëve të kalibrit... mm dhe këto predha janë gjuajtur nga pistoletë e markës “...” e kalibrit... mm, me numër serik ... e cila është verzion i pistoletës gjermane “...”. Gjithashtu edhe ato 6 gëzhojat e përmendura të grupi i parë i dëshmive, e të cilat janë evidentuar me numrat 6, 9, 11, 12, 17 dhe 24 janë shkrepur nga kjo armë.

Në grupin e tretë të dëshmive, është vetëm një predhë e fishekut të kalibrit... mm, ku kjo dëshmi evidentohet me nr.26 dhe është një predhë e dëmtuar.²⁴ Pas ekzaminimit të bërë, është konstatuar se dëshmia me nr.26 është një predhë e dëmtuar, pjesë e fishekut të kalibrit... mm e cila është gjuajtur nga pistoletë “...” e kalibrit... mm, me numër serik

²² Nga Raporti i Ekspertizës, AKF/2013-3662/2013-2808, shihet se këto dëshmi janë pranuar në AKF, më datën 21.11.2013.

²³ Nga Raporti i Ekspertizës, AKF/2013-3662/2013-2900, shihet se këto dëshmi janë pranuar në AKF, më datën 05.12.2013.

²⁴ Nga Raporti i Ekspertizës, AKF/2013-3662/2014-185, shihet se kjo dëshmi është pranuar në AKF, më datën 04.02.2014.

Te grupi i katër i dëshmime, vetëm një predhë e kalibrit... mm, e cila predhë është gjuajtur nga pistoleta “...” e kalibrit... mm, me numër serik ...²⁵

Në fund, eksperti ka sqaruar se shprehjen të cilën e ka përdorur tek grupi i tretë i dëshmime se predha ka qenë e dëmtuar, ka dashur të thotë se kjo predhë ka qenë predhë e shtypur-“tumavt” dhe nuk kemi të bëjmë me ndarje të predhave.

2.4. Provat materiale

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të cilin e kanë përpiluar zyrtarët policor të Njësisë së Forenzikës shihet se në vendin e ngjarjes janë identifikuar dhe fiksuar 24 dëshmi të cilat janë marrë në cilësi të provave materiale. Në hyrje të vendit të ngjarjes nga rruga kryesore janë vërejtur njolla gjaku të cilat janë identifikuar #1, #2, #3, #4 dhe #22. Me nr.#5 është evidentuar një shufër metA.ke, #7 pjesë e shufrës metA.ke, #6, #9, #11, #12, #17 dhe #24, janë identifikuar gëzhoja e kalibrit 7.65 mm, #8 dhe #21 dy sopata dhe #10 janë identifikuar rroba, të cilat i takojnë njërit prej viktimave, ku te trinerka është vërejtur në anën e majtë të gjoksit një vrimë, në anën e djathtë një të qarë, në pjesën e stomakut nga ana e djathtë dhe në krahun e majtë në pjesën e sipërme kishte nga një të qarë. Me numër #13 është evidentuar një drapër, #14 një karikator i armës .. me 8 fishekë të kalibrit... mm, #15 një fotrollë e thikës, #16 një palë dana, #18, #20 dhe #23 janë identifikuar thika, ndërsa #19 është evidentuar një pistoletë ... e kalibrit... mm, me nr.serik Trupat e të ndjerëve A. dhe F. L., janë fotografuar nga ana e zyrtarëve policor dhe më pastaj janë dërguar në Departamendin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.

Nga skica e përpiluar nga zyrtarët policor të Njësisë së forenzikës shihet që të gjitha provat-dëshmitë e lartcekura janë gjetur në rrugë e cila shpie nga rruga kryesore e deri te rruga që shkon te shtëpia e të ndjerëve ndërsa dëshmitë 17, 18, 19, 20 janë gjetur afër ndërtesës që është në ndërtim e sipër e që ka qenë pronë e të ndjerëve përkatësisht afër hyrjes së garazhës së kësaj ndërtese, kurse dëshmitë 21, 22 dhe 23 janë gjetur në rrugën që përshkon në drejtim të tregut. Të gjitha këto dëshmi mund të shihen edhe nga fotografitë e vendit të ngjarjes të cilat janë bërë nga ana e zyrtarëve policor natën kritike. Distanca në mes të 24 dëshmime të lartcekura dhe tri Pikave Fikëse është paraqitur në legjendën e matjeve e cila gjithashtu është administruar si provë e administrimit gjyqësor.

Në raportin e oficerit të cilin e ka përpiluar B. B., i cili edhe ka qenë njëri ndër zyrtarët policor në vendin e ngjarjes, shihet që i njëjti e ka përshkruar ngjarjen përafërsisht në mënyrë të njëjtë me atë çka kishte dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nga raporti i shpejtë i Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Gjilan, shihet që të gjitha dëshmitë e lartcekura janë tërhequr nga

²⁵ Nga Raporti i Ekspertizës, AKF/2013-3662/2014-1952, shihet se këto dëshmi është pranuar në AKF, më datën 19.06.2014.

vendi i ngjarjes për ekzaminim të mëtejshëm si dhe janë ndërmarrë veprime tjera hetimore që kanë të bëjnë me kërkimin e të akuzuarve, ofrimin e sigurimit për të lënduarit A. dhe F. L..

Nga akt-ekspertimi mjeko ligjor të cilin e ka përpiluar Dr.Musa Gashi, mjek ligjor shihet që i dëmtuari F. L. ka pësuar dëmtime të cilat paraqesin grumbullim të ajrit dhe gjakut në hapsirën pleurale-masiv traumatik në anën e djathtë si pasojë e plagës sklopetare (nga armë zjarri) në regjionin nën klavikular të anës së djathtë, gjakderdhje në mediastinum (hapsira mes dy mushkrive), thyerje në unazën e katërt torakale të shtyllës kurrizore, prezencë të trupit të huaj metA.k të kanA.n spinal në regjionin e unazës së pestë torakale të shtyllës kurrizore (i cili është hequr me operim) dhe me parA.zë të dy këmbëve, të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit. Këto dëmtime për nga natyra e tyre bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore me pasoja të përhershme për shëndetin. Nga akt ekspertimi i lartcekur, po ashtu shihet se edhe i dëmtuari F. L. ka pësuar dëmtime që paraqesin grumbullim të ajrit dhe të gjakut në hapsirën pleurale-traumatik në anën e majtë si pasojë e plagës sklopetare (nga armë zjarri) në regjionin aksillar të anës së majtë, thyerje të brinjëve 6 dhe 7 të anës së majtë të kafazit të kraharorit, prezencë të trupit të huaj në anën e pasme të majtë të kafazit të kraharorit si dhe ndrydhje hemoragjike në mushkrinë e majtë të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit. Këto dëmtime që ka pësuar i dëmtuari A. L. për nga natyra e tyre bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Gjithashtu nga akt ekspertimi i lartcekur shihet që edhe të akuzuarit F.dhe R. M. kanë pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. I akuzuari F.M. ka pësuar dëmtime që paraqesin gjendje pas marrjes së plagës prerëse me gishtin e tretë të dorës së djathtë dhe në gishtin e katërt të dorës së majtë, të cilat i janë shkaktuar nga veprimi mekanik i trupit të fortë dhe të mbrehtë, kurse i akuzuari R. M. ka pësuar dëmtime që paraqesin gjendje pas marrjes së plagës shqyese e ndrydhëse në gishtin e pestë të dorës së djathtë, të cilat janë shkaktuar nga veprimi mekanik i trupit të fortë mbrehtës (jo të mprehtë). Sa i përket natyrës së lëndimeve të dëmtuarve F. dhe A. L., janë bërë dy ekspertiza mjeko ligjore nga ana e Dr.Sejdullah Mahmuti, i cili ka dhënë mendim të njëjtë me atë të ekspertit mjeko ligjor Dr.Musa Gashi.

Nga fletëlëshimi nr.8068, shihet se i dëmtuari F. L. i është nënshtruar tretmanit mjekësor nga data 15.11.2015 e deri me datën 26.11.2013 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe gjithashtu nga raporti mjekësor një pjesë e të cilit është përkthyer në gjuhën shqipe shihet se i dëmtuari F. L. i është nënshtruar tretmanit mjekësor në SpitA.n "...", Mjekësia Funktionale dhe Qendra e Rehabilitimit Fizik në Bangkok.

Nga fletëlëshimi nr.8060 shihet se i dëmtuari A. L. i është nënshtruar tretmanit mjekësor nga data 15.11.2013 deri me datën 21.11.2015 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Përveç këtyre nga raportet e Emergjencës së SpitA.t Regjional në Gjiilan, të datës 14.11.2013, shihet se të dëmtuarit F. dhe A.

L. fillimisht natën kritike janë dërguar në këtë Emergjencë, për shkak të plagëve nga ana e zjarrit për tu transferuar më pastaj në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Nga raportet e Emergjencës së SpitA.t Regjional në Gjilan, të datave 25.11.2013, shihet se edhe të akuzuarit Fehmi dhe R. M. janë trajtuar për shkak të lëndimeve në gishtat e duarve.

Përveç deklarimeve të tyre gojore në seancat e shqyrtimit gjyqësor, ekspertët Dr.Arsim Gërxhaliu, Hidajete Muharremi dhe Qëndrim Topalli, i kanë ekspertizat e tyre edhe në formë të shkruar të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përveç raportit të ekspertizës AKF/2013-3662/2014-1952 të cilën e ka përpiluar ekspertja Hyrije Hoxha. Me pëlqimin e Prokurorit të Shtetit, përfaqësuesit të palës së dëmtuar si dhe mbrojtësve të akuzuarve mendimin dhe konstatimin sa i përket këtij raporti të ekspertizës gojarisht e ka prezentuar eksperti Qëndrim Topalli edhe pse atë me shkrim e kishte përpiluar kolegia e tij-ekspertja Hyrije Hoxha.

Përveç ekspertizave mjeko-ligjore, eksperti Dr.Arsim Gërxhaliu, trupit gjykues ia ka sjellur edhe fotografitë e të ndjerëve A. dhe F. L. të cilat janë bërë para dhe gjatë kryerjes së autopsisë së tyre në Departamentin për mjekësi ligjore në Prishtinë për të ndjerin F. L. janë bërë 75 fotografi ndërsa për të ndjerin A. L. janë bërë 69 fotografi dhe të gjitha këto fotografi janë administruar si prova materiale. Nga të gjitha këto fotografi mund të shihen dëmtimet të cilat i kanë pësuar të ndjerët A. dhe F. L..

Për të vërtetuar në mënyrë sa ma të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, si dhe për të pasur një vlerësim sa ma real të provave, trupi gjykues së bashku me Prokurorin e shtetit, përfaqësuesin e palëve të dëmtuara, mbrojtësit e të akuzuarve si dhe me zyrtarët policor nga Njësiti i Forenzikës, me datën 19.05.2015, kanë dalur dhe kanë bërë shiqimin e drejtpërdrejtë të vendit të ngjarjes. Zyrtarët policor të Njesisë së Forenzikës kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes si dhe matjen e disa pikave të caktuara në vendin e ngjarjes, siç janë: distanca në mes të derës së shtëpisë së viktimave dhe derës së hyrjes së oborrit (distanca 10.40m), distancës në mes të dritës e cila ka qëndruar natën kritike dhe skajit të garazhës së objektit që është në ndërtim e sipër (distanca 18.05m), gjerësisë së rrugës para derës së oborrit të shtëpisë së të ndjerve (distanca 3.90m), si dhe distancës në mes të skajit të garazhës së objektit që është në ndërtim e sipër dhe skajit të depos së materiA.t ndërtimor, përndryshe pllaci i R. M.(distanca 5.2m).

Nga Raporti shtesë i hetimeve, i datës 02.09.2014, zyrtarët policor të Njesisë së Hetimeve Rajonale në Gjilan, duke vepruar sipas urdhërit të kësaj Gjykate, UGJK.162/14, me të cilin është urdhëruar zbatimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, kanë analizuar të dhënat e siguruar nga operatori telefonik "...". Pas kësaj anA.ze, është gjetur se i pandehuri B. Sh., më datën 14.11.2013, në ora 23:40 minuta, nga numri i tij telefonik ... ka dërguar një mesazh telefonik me këtë përmbajtje "U kan mir me nreq ket pun diqysh se me

ba problem mu mqihet nana” në numrin e telefonit ..., të cilin ka qene duke e shfrytëzuar i akuzuari F.M.. Kjo mund të shihet edhe nga mesazhet telefonike që gjenden në shkresa të lëndës.

Nga kopja e planit, nr.11-1311-05, e datës 06.07.2005, shihet pozita e parcelës në të cilën është e ndërtuar shtëpia e të ndjerëve, pozita e parcelës në të cilën është në ndërtim e sipër ndërtesa nga familja e të dëmtuarve, si dhe rruga prej shtëpisë së të dëmtuarve e deri te skaji tjetër i ndërtesës që është në ndërtim e sipër. Të gjitha këto, janë të evidentuar në emër të Ibrahim L., përndryshe babë i të ndjerëve, F.1dhe A. L.. Kurse, nga certifikata me numër P-... dhe nga kopja e planit, shihet se rruga prej skajit të ndërtesës që është në ndërtim e sipër e deri te kioska është në bashkëpronësi të I. L., me 2/4; D. J., me 1/4 dhe K. S., me 1/4.

Përmes raportit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të datës 24.04.2015, shihet se në dhomën #8 në të cilin ka qenë i akuzuari B. B., është gjetur një telefon mobil “...”, e kartelë të “...”, ku i akuzuari B. B., e kishte pranuar se kishte folur me këtë telefon.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës, i datës 26.11.2013, nga Raporti Informativ Hetimor, i datës 04.02.2014, si dhe shkresa tjera policore, shihet se më datën 25.11.2012, të akuzuarit F.dhe R. M., janë dorëzuar në Stacionin Policor në Gjilan, ndërsa i akuzuari F.M., e kishte dorëzuar edhe një revole e markës “...”, e kalibrit... mm, së bashku me një karikator. Kjo revole me karikator është sekuestruar, fotografuar dhe është dërguar në procedurë të ekzaminitimit. Gjithashtu, janë fotografuar edhe të akuzuarit F.dhe R. M., fotografi këto që gjenden në shkresa të lëndës, nga të cilat shihet se të akuzuarit F.dhe R. M., i kanë të mbështjellura me fashë gishtat e duarve të lënduara.

Nga Raporti Shtesë i Hetimeve dhe nga listat e PTK, lidhur me numrin e telefonit ..., shihet se këtë numër e ka shfrytëzuar i akuzuari R. M., i cili natën kritike, një orë para se të ndodhë rasti, ka komunikuar përmes telefonit me numrin telefonik ..., ku nga shkresat e lëndës, shihet se ky numër i telefonit ka qenë i të dëmtuarit F. L.. Nga këto shkresa të lëndës, shihet se i akuzuari R. M., përmes numrit të lartcekur të telefonit, ditën kritike ka reA.zuar disa thirrje hyrëse dhe dalëse, mirëpo pas anA.zave nga ana e zyrtarëve policor, është vërejtur se i njëjti nuk ka pasur kontakt telefonit me numrin ..., pronë e të akuzuarit B. B.. Ndërsa, nga kjo listë e PTK, shihet se i akuzuari R. M., përmes numrit të telefonit ..., natën kritike ka patur kontakt telefonik me të pandehurin B. Sh., përmes numrit të telefonit ..., në 22:53 minuta.

Gjithashtu, si prova materiale janë administruar edhe skicat të cilat i kanë plotësuar i dëmtuari F. L. dhe dëshmitari B. B., të cilët kanë treguar pozitën e personave në momente të caktuara.

2.5. Deklarimi i të akuzuarve

2.5.1. I akuzuari F.M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar faktin se natën kritike i ka privuar nga jeta të ndjerët A. dhe F. L., si dhe i ka plagosur të dëmtuarit A. dhe F. L.²⁶ I akuzuari F.M., mandej ka shtuar se natën kritike, pasi që e kishte rregulluar veturën e tij, kishte shkuar te motra e tij për të ngrënë darkë, ngase aty kishin qenë edhe bashkëshortja me nipin e tij dhe aty kishin qëndruar deri kah ora 23:00. Derisa ishte te motra e tij, e kishte thirrë në telefon djA. i tij – i akuzuari R. M., i cili e kishte pyetur të akuzuarin F.M., se mos ka patur ndonjë konflikt gjatë ditës me A., F.1 apo F., përkatësisht me familjen L., ngase të njëjtit kanë dashur që ta presim të akuzuarin R. M.. Pas kësaj i akuzuari F. është nisur për në shtëpinë e tij dhe e kishte ftuar dajën e tij, Sh. për të ndërmjetësuar me familjen e të dëmtuarve, duke i thënë të njëjtit se dil në rrugë se po vi me të marrë, mirëpo nuk kishte arritur që të shkonte për ta marrë. I akuzuari F.M., derisa ishte duke e kërkuar nëpër disa kafiteri të akuzuarin R. M., përmes pasqyrës së veturës kishte parë A.n, F.1, F., A. dhe I.. Gjatë kësaj kohe, F.1 dhe F.i, e kishin nga një sopatë në dorë, kurse A. e kishte një drapër. Pas një bisede-fjalosje të shkurtër rreth rrëzimit të paletave, të njëjtit kanë shkuar deri te oborri i shtëpisë së të ndjerëve dhe gjatë bisedës në mes vete, ka ardhur i akuzuari R. M., i cili e ka ftuar të akuzuarin F.M., duke i thënë se hajde në shtëpi, ku në atë moment, F.1, F. dhe A., e kanë sulmuar të akuzuarin R.. Meqenëse ishte errësirë - terrë, kishte bërtitur "nalnu, nalnu" dhe aty e kishte parë se është lënduar në kokë i akuzuari R. me thikë, sakicë dhe drapër. Në ato moment, i akuzuari F.M., e kishte nxjerr revolën dhe kishte dashur që të gjuaj përpjet, gjithashtu në ato momente i ndjeri A. e kishte nxjerr revolen, ndërsa i akuzuari F., revolen e tij e kishte futur në xhep dhe kishte filluar të kacafytet me të ndjerin A., duke dashur që t'ia marrë revolën A., me ç'rast ishte shkrepur një predhe nga kjo revole. Gjatë kësaj kohe, A. dhe I., e kishin sulmuar të akuzuarin F. dhe gjithashtu të njëjtin e kishte sulmuar edhe i dëmtuari A. me një drapër. Pas kësaj kishte ardhur i akuzuari R. dhe i kishte tërhequr A. dhe F., mandej i ndjeri A. ia kishte drejtuar revolën të akuzuarit R. ndërsa i akuzuari F. e kishte nxjerrë revolën dhe kishte shtënë një herë në drejtim të të ndjerit A., duke dashur që ta godas në dorë, mirëpo nuk e dinë se ku e ka goditur të ndjerin. Në këtë moment, A. ka qenë larg nga i akuzuari F., diku një deri në një metër e gjysmë. Pas kësaj, i akuzuari F., kishte shtënë një herë në drejtim këmbëve të F., për shkak se i njëjti kishte dashur që ta sulmonte me thikë të akuzuarin R. mirëpo i akuzuari F. nuk e ka ditur se cilën pjesë të trupit e ka goditur të dëmtuarin F..

Gjithashtu, ka deklaruar se është e vërtetë se ka shtënë një herë edhe në drejtim të A. dhe ka dashur që të gjuaj në drejtim të këmbëve, mirëpo nuk e dinë se në cilën pjesë të trupit e ka goditur të njëjtin, ku në këtë moment distanca në mes tij dhe A. ka qenë një ose një metër e gjysmë. Pas kësaj, i akuzuari F. e

²⁶ Trupi gjykues, pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, si dhe avokatëve, nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, sipas dispozitivit I të aktakuzës së paraqitur fillimisht, nga ana e të akuzuarit F. M., ngase trupi gjykues ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit, F. M., avokati N. N.i, ka deklaruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë.

kishte kthyer kokën mbrapa dhe e kishte parë të ndjerin F.1 me një sopatë në dorë, duke dashur që ta prejë të akuzuarin F., ku i njejtë kishte ikur mbrapa kah drejtimi i kioskës, duke kërkuar nga "ndalu F.", mirëpo i njejtë nuk është ndalur, me atë rast i akuzuari F. ka gjuajtur me një predhë në drejtimin e tij, i cili nuk është rrëzuar dhe i akuzuari F., ka menduar se është goditur në këmbë. Pas kësaj, i akuzuari F., i ka thënë përsëri të ndjerit F.1 "ndalu", mirëpo ai nuk është ndalur dhe derisa ishte duke u larguar nga mbrapa aty, veç se gati sa është rrëzuar dhe meqë e kishte revolen në duar janë gjuajtur predhat, mirëpo nuk e dinë se në cilën pjesë të trupit e ka goditur F.1, veç se e kishte parë se i njejtë është rrëzuar në tokë. Pas kësaj, i akuzuari R. M., i cili ishte nën A. dhe F., kishte ardhur, e kishte kap për krahu të akuzuarin F., si dhe ja kishte marrë armën në mënyrë që të shkojnë në polici, mandej që të dy kanë shkuar kah rruga që kalon kah parku dhe që shkon në drejtim të tregut, për të shkuar më pastaj në S.. Armën e lartcekur i akuzuari R. e kishte marrë pasi që veç se i akuzuari F. e kishte goditur të ndjerin F.1 dhe e kishte përfunduar sulmin. Gjatë qëndrimit në S., i akuzuari R. i është nënshtruar një tretmani mjekësor për shkak të lëndimeve që kishte marrë natën kritike.

Sa i përket të akuzuarit B. dhe të pandehurit B., i akuzuari F., ka deklaruar se të njejtë nuk i ka parë natën kritike, ndërsa lëndimet të akuzuarit F., ja ka shkaktuar A. dhe A.. Prej momentit kur në vendin e ngjarjes ka ardhur i akuzuari R. e derisa të njejtë janë larguar nga vendi i ngjarjes, kjo ngjarja ka zgjatur 3-5 minuta dhe gjatë kësaj kohe ka patur frikë dhe tronditje.

Sa i përket të akuzuarit R. i akuzuari F. ka deklaruar se nuk ka vërejtur që i njejtë të ketë patur ndonjë sopatë apo mjet tjetër.

Sa i përket armës të cilën e ka përdorur natën kritike, i akuzuari F. ka deklaruar se këtë armë e ka mbajtur "non-stop" që nga viti 1993, çka do të thotë se atë armë nuk ka shkuar për ta marrë në shtëpi kur e ka lënë veturën, ndërsa e ka mohuar faktin që natën kritike të ketë patur ndonjë thikë me vete.

Sa i përket errësirës dhe mundësisë së shkuarimit, i akuzuari F.M., ka natën kritike ka qenë errësirë-pa drita, përveç asaj drites që ka qenë afër oborrit të shtëpisë, mirëpo nuk ka qenë errësirë totale dhe ka mundur që t'i shoh veprimet e personave, ngase edhe ashtu kanë qenë afër.

2.5.2. I akuzuari R. M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, duke shtuar se ditën kritike së bashku me nënën edhe djalin e tij, ka shkuar te halla e tij, ndërsa pas kësaj e kishte ftuar përmes telefonit A. i, me të cilin kishin pirë kafe në një kafiteri. Pas një kohe, diku rreth orës 21:30 kishte shkuar te kioska e tij dhe aty afër kishte vërejtur se kishin qenë I.i, F.1, A., F. dhe A.. Gjithashtu, aty kishte qenë edhe punëtori i tij, E., i cili ishte duke i mbyllur frizat, mirëpo, njërinë prej tyre nuk kishte mundur që ta mbyll, për shkak se zinxhirët kishin qenë të zënë me paleta. Meqë më parë, dikush i kishte rrëzuar paletat, i ndjeri F.1, kishte qenë nervoz dhe i kishte bërë titur të akuzuarit R. se mos t'i prek, se këto janë të tij 5

metra, ndërsa A. e kishte nxjerr një drapër, kurse F., kishte nxjerr diçka, por nuk i kujtohet saktësisht. Në ato momente, i ndjeri A. e ka kap të akuzuarin R. duke i thënë të njëjtit se "leje" se këta janë nervoz, ku i njëjti e ka marr të akuzuarin R. dhe së bashku me te kanë shkuar kah kioska te poshtë, me ç'rast edhe i akuzuari R. kishte shkuar te shtëpia e tij. Pas kësaj e kishte ftuar në telefon të dëmtuarin F. për ta pyetur se çka ka ndodhur, ndërsa babai i tij-i ndjeri F.1 e kishte sharë. Gjithashtu, përmes telefonit, i akuzuari R. e kishte njoftuar edhe babain e tij-të akuzuarin F. për rastin që i kishte ndodhur. Mandej, i akuzuari R. me veturën e tij "... " kishte shkuar për qef në K. dhe e kishte marr të akuzuarin B. me të cilin ishin shëtitur nëpër K., ndërsa më pastaj ishin nisur edhe për Gj., ku në hyrje të Gj. i kishte treguar të njëjtit për mosmarrëveshjen që e kishte me të dëmtuarin, kurse i akuzuari B. kishte kërkuar që ta lë këtë punë, për shkak se që të dy e kanë njohur F.. Pas kësaj ishte nisur në drejtim të shtëpisë së tij dhe pasiqë kishte dal nga vetura e kishte dëgjuar zërin e babait të tij, me ç'rast edhe kishte vrapuar në drejtim të vendit të ngjarjes. Nuk e din se si ka ardhur i akuzuari B. në vendin e ngjarjes, por e din që ai ka qenë në vendin e ngjarjes. Kur i akuzuari R. ka shkuar në vendin e ngjarjes aty ka parë se F.1, A., F. e A. dojshin që ta sulmonin babain e tij. Në vendin e ngjarjes kishin qenë I. dhe A.. Kur i njëjti kishte arritur në vendin e ngjarjes në drejtimin e tij ishte vërsulur F.1, ndërsa kah babai i tij ka shkuar A.. Kah babai i tij ka shkuar edhe A., ndërsa në drejtim të akuzuarit R. ka shkuar edhe F.. F. dhe F.1, i akuzuar R. i kishte bërë bashkë dhe i kishte thënë ndalnu, ku në ato momente i akuzuari R. nuk kishte asgjë me vete. Gjatë këtyre momenteve "ka kërshur alltia" dhe i akuzuari R. mendon që A. i nga mbrapa e ka sulmuar me një drapër, ndërsa edhe i akuzuari F. e kishte sulmuar të akuzuarin R. pasiqë i njëjti ia kishte kapur sopatën F.1. Pas kësaj, i akuzuari R. është tërhequr nga mbrapa nga drejtimi i ndërtesës që është në ndërtim e sipër dhe pas tij ka shkuar A. me një revole në dorë dhe gjithashtu pas tij edhe F.. Në këto momente babai i tij gjendej afër qoshit të pllacit të R. M. ku afër tij kishin qenë A. dhe F.1. Babai i tij-i akuzuari F.M. kishte bërtitur "nalnu, nalnu A." dhe në këto momente i akuzuari R. e kishte dëgjuar një të krisur. Pas kësaj krisme, kishte vërejtur që A. ka ardhur në drejtimin e tij sikur kur e shtyn dikush dhe ka rënë mbi trupin e të akuzuarit R. i cili së bashku me te është rrëzuar në tokë. Pas kësaj afër këtyre dyve ka ra edhe F. në momentin kur i akuzuari R. e kishte dëgjuar edhe krismën tjetër. Gjatë kohës sa i akuzuari R. ishte i shtrirë në tokë kishte dëgjuar edhe të shtëna tjera, mirëpo nuk e din se sa të shtëna. Mandej i akuzuari R. e kishte shtyr A. për të cilin nuk e kishte ditur se është i vdekur dhe ishte ngritur në këmbë, ku ishte nisur në drejtim të babait të tij i cili gjendej për afërsisht në mes të pllacit të R. M. dhe ndërtesës së oficerëve. Në ato momente kur kishte shkuar te babai i tij e kishte parë se i njëjti ishte i mërzhitur dhe i tronditur, kurse në tokë të shtrirë e kishte parë F.1. Pas kësaj i akuzuari R. ia kishte kap revolen babait të tij, e cila nuk kishte asnjë fishekë dhe së bashku me të ishin nisur kah drejtimi që shkon kah parku-rruga e tregut. I akuzuari R. ka dashur që të paraqitet në Stacionin

policor, mirëpo babai i tij është frikësuar, andaj me veturën “...” është nisur për në S., ku atje i njëjti i është nënshtruar një tretmani mjekësor.

I akuzuari R. e ka mohuar faktin se në momentin kur ka shkuar në vendin e ngjarjes duke vrapuar të ketë patur sopatë me veti. Natën kritike i akuzuari B. nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, por vetëm e ka shoqëruar të akuzuarin R.. Të akuzuarit R. nuk i është kujtuar nëse natën kritike rreth orës 22;53 minuta të ketë komunikuar përmes telefonit me të pandehurin B. Sh.. I akuzuari R. me vetëdijen e tij natën kritike nuk e ka sulmuar askënd, mirëpo sipas tij gjatë kohës kur ia ka marrë thikën F. ka mundur të lëndohet ndokush, përkatësisht ka mundur të lëndohet A.. A. ka mundur që ta lëndoj edhe F., ngase F. ka goditur pa u ndal. Gjithashtu, edhe të ndjerin F.1 ka mundur ta godas F. dhe të akuzuarit R. nuk i kujtohet që e ka goditur F.1 me thikë, por nuk përjashtohet një mundësi e tillë, sepse i njëjti është munduar që të mbrohet dhe këtë thikë i njëjti e kishte lënë në vendin e ngjarjes. I akuzuari R. gjithashtu e ka mohuar faktin që ka shtënë me armë në drejtim të F., siç e ka mohuar edhe faktin se ka tentuar të shtënë tri herë me armë në drejtim të tij derisa i njëjti ka qenë i shtrirë në tokë. Në kontekst të kësaj, i akuzuari R. M., ka shtuar se revolen ia kishte marrë babait të tij, pasi që i njëjti ishte i tronditur dhe kjo ka ndodhur pasi që veç kishte përfunduar rasti dhe revolja nuk kishte fishekë.

Pas ballafaqimit me deklaratën e tij të dhënë në prokurori, ku në pyetjen “meqë përmendet se B. ka qenë prezentë atë ditë a e ke vërejtur se si ka vepruar i njëjti?”, i akuzuari R. ishte përgjigjur “po e di që njëherë e ka shtyrë A. te mbrapa dhe nuk e ka vërejtur se ku ka shkuar”. Lidhur me këtë i akuzuari R. M., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kur kishte thënë se i akuzuari B. nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, kishte dashur të thotë se i njëjti nuk e ka sulmuar askënd, kështu që ka mundur të ndërhyj për ta ndal ndokënd. Sa i përket të pandehurit B. Sh., i akuzuari R. M. ka deklaruar se i njëjti nuk ka qenë në vendin e ngjarjes.

2.5.3. I akuzuari B. B., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se natën kritike e kishte ftuar i akuzuari R. M. i cili i ishte para derës së shtëpisë së tij dhe pas kësaj i akuzuari B. kishte dalur jashtë dhe kishte hyrë në veturën e të akuzuarit R.. Pas një bisede të shkurtër kishin vendosur që të shkojnë në Gj. dhe rrugës në hyrje të Gj., i akuzuari R. e kishte njoftuar se e ka sulmuar dhe sharë babai i F. L. lidhur me disa paleta që ishin rrëzuar, ndërsa i akuzuari B. kishte thënë që “shyqyr që skoka bo ma e madhe, se jeni familjar”, duke kërkuar nga i akuzuari R. që të shkojnë te shtëpia e tij. Kur kanë hyrë në oborr të shtëpisë së tij, aty e ka takuar nënën e të akuzuarit R. të cilën e ka pyet se a gjendet në shtëpi i akuzuari F., kurse e njëjta i ka thënë se ka dal dhe kanë provuar që ta thërrasin në telefon, ku gjatë kësaj kohe kishte parë që i akuzuari R. nuk ishte më në oborr, pas kësaj i akuzuari B. ka dal nga oborri i shtëpisë me ç’rast ka dëgjuar bërtimën dhe të shara në mes të një grupi të personave të cilët gjendeshin në mes të B. së B. dhe objektit që ishte në drejtim e sipër. Pasi të njëjtit ishin duke u

përleshur, kishte parë që të njëjtit e kishin rrethuar të akuzuarin R. mirëpo nuk e di se kush e kishin rrethuar, ngase ishin 5-6 persona. Kur është ofruar më afër kishte parë që njeri prej këtyre personave e kishte një llos-dru në dorë i cili ishte matur me atë dru dhe me që i akuzuari B. ishte mbrapa tij, ka arritur që t'ia tërheq atë llos dhe të njëjtin e kishte gjuajtur në tokë. Në atë moment kishte ardhur A. i nga drejtimi i kioskës i cili i kishte thënë: “B. edhe ti këtu a, të lutem mos u përzi”, ndërsa i akuzuari B. i kishte thënë A. “moni se u gazit” dhe para se ti përfundoj këto fjalë e kishte dëgjuar një të krisur të armës. Me të dëgjuar këtë krismë të armës ishte larguar me vrap nga vendi i ngjarjes, kishte dal në rrugë kryesore dhe me një taksi kishte shkuar në K.. Të nesërmen në mëngjes kur kishte kuptuar se ka ndodhur vrasje dhe plagosje ishte paraqitur në Stacionin Policor në Kamenicë, ndërsa më pastaj është sjellur në Stacionin Policor në Gjilan. Pasi që ishte larguar nga vendi i ngjarjes, i akuzuari B. kishte dëgjuar edhe krisma tjera të armës.

I akuzuari B. B. ka deklaruar se me të akuzuarin R. M. ka patur raporte të mira shoqërore dhe jam vizituar familjarisht, ndërsa natën kritike në vendin e ngjarjes nuk e kishte parë të akuzuarin F.M. dhe nuk ka patur asgjë me veti, përkatësisht as një thikë apo revole, përveç atij llosit që ia kishte tërheq atij personit. Gjithashtu, i njëjti ka deklaruar se natën kritike nuk e ka sulmuar askënd, siç nuk e din se kush i ka sulmuar të ndjerët F.1 dhe A. L.. Natën kritike derisa kanë qenë së bashku me të akuzuarin R. i njëjti nuk ka parë që i akuzuari R. të ketë patur ndonjë mjet apo send me veti.

3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Trupi gjykues i ka vlerësuar dhe analizuar me shumë kujdes të gjitha provat që janë administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Të gjitha provat janë vlerësuar dhe analizuar një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë këtij vlerësimi dhe analizimi, trupi gjykues ka nxjerrë konkludime nëse një fakt konkret është provuar apo jo. Provat janë vlerësuar dhe analizuar vetëm për faktet që janë relevante në këtë çështje penale dhe për ato fakte që kanë qenë kontestuese nga ana e palëve në këtë çështje penale.

Duke e analizuar deklaratat e të akuzuarit F.M., të dhënë gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi deklaramit të tij, i cili e ka pranuar faktin se natën kritike me revolën e tij i ka privuar nga jeta të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe i ka lënduar të dëmtuarit A. dhe F. L.. Kjo për faktin se një pohim i tillë i të akuzuarit F.M., është bindës, logjik dhe gjen mbështetje edhe në provat tjera të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Edhe me provat tjera që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se i akuzuari F.M., i ka privuar nga jeta të ndjerët A. dhe F. L., si dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarve A. dhe F. L.,

duke shtënë në drejtim të tyre me revolen e markës “...” e kalibrit ...mm, të cilën e ka mbajtur pa autorizim dhe pa leje. Se i akuzuari F.M., e ka privuar nga jeta të ndjerin A. L., mund të vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarit F. L., i cili kishte deklaruar se e kishte parë se i akuzuari F. ka shtënë me armë në drejtim të A.. Pra, ky fakt mund të vërtetohet edhe përmes një dëshmitari okular, i cili vetë e ka parë se i akuzuari F. ka shtënë me revole në drejtim të ndjerit A1.. Poashtu, një gjë e tillë mund të vërtetohet, në një mënyrë edhe nga vetë deklaratat e të akuzuarit R. M., i cili përveç tjerash kishte deklaruar se “Babai i tij-i akuzuari F.M. kishte bërë titur... dhe në këto momente i akuzuari R. e kishte dëgjuar një të krisur. Pas kësaj të krisme kishte vërejtur që A. ka ardhur në drejtimin e tij sikur kur e shtyn dikush dhe ka rënë mbi trupin e të akuzuarit R. i cili së bashku me të është rrëzuar në tokë”. Në anën tjetër, faktin se i akuzuari F.M., e ka privuar nga jeta të ndjerin F. L. dhe ka shtënë në drejtim të dëmtuarit A. L., përveç deklaratës së të akuzuarit F.M., mund të vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarit A. L., i cili përveç tjerash ka deklaruar se “Në momentin kur i dëmtuari A. L., kishte arritur në vendin e ngjarjes, kishte tentuar që ta qetësojë situatën, duke ju thënë “ndalnu, ndalnu”, ku në ato momente e kishte parë që i akuzuari F.M., e kishte nxjerr revolen dhe i dëmtuari A. L., i cili ishte afër babait të tij, i kishte thënë të akuzuarit F. “hjeke alltinë së naj more fytyrën”, ndërsa i akuzuari F. e kishte shkrepur revolen në drejtim të dëmtuarit A. L., me ç’rast një plumb e kishte goditur të njëjtin në krahërorin e majtë.... Para se i akuzuari F. shkrepnte në drejtim të dëmtuarit A. Pas goditjes me armë të zjarrit, i dëmtuari A. L. është rrëzuar në anën e djathtë të krahërorit, ku prindi i tij – i ndjeri F. L., ka dashur që ta kap për krahërori të djathtë dhe ta tërheq të dëmtuarin A. L. nga vendi i ngjarjes. Gjatë këtyre momenteve, babai i të dëmtuarit-i ndjeri F. L., është goditur me një predhë në krah nga drejtimi i të akuzuarit F.”. Në këtë drejtim, deklaratat e të dëmtuarit A. L., është vlerësuar si tejet e besueshme dhe bindëse për trupin gjykues, ngase nuk është në kundërshtim edhe me deklaratën e të akuzuarit F.M.. Në anën tjetër, deklarimi i të dëmtuarit A. L., sa i përket këtij fakti (fakti se i akuzuari F. ka shtënë me armë në drejtim të dëmtuarit A. dhe në drejtim të babait të tij – F.1), është konsistente dhe në harmoni edhe me deklaratimet e tij të mëparshme të dhënë pranë oficerëve policor dhe pranë prokurorit të shtetit. Lidhur me këtë fakt, i dëmtuari A. L., ka qenë dëshmitar okular dhe pavarësisht moshës së tij të re, deklarimi i tij në këtë aspekt është vlerësuar si tejet objektiv dhe i logjikshëm, ku si rezultat i këtyre edhe i është falur besimi i plotë nga ana e trupit gjykues. Në anën tjetër, edhe vetë i akuzuari F.M., gjatë të gjitha fazave të procedurës penale e ka pranuar faktin se i ka privuar nga jeta të ndjerët A. dhe F. L., si dhe ka shtënë me armë në drejtim të dëmtuarit A. L.. Nga të gjitha këto, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se të ndjerët i ka privuar nga jeta i akuzuari F.M., i cili edhe e ka pranuar një fakt të tillë dhe një gjë e tillë mund të vërtetohet edhe nga rrjedha logjike e kësaj ngjarje; nga pozita e personave të involvuar në këtë rast, siç është përshkruar me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, etj. Përveç këtyre, i akuzuari

F.M., e ka pranuar faktin se ka shtënë me armë edhe në drejtim të dëmtuarit F. L.. Për trupin gjykues një deklaram i tillë i të akuzuarit F.M., është i bindës dhe i besueshëm, për shkak se armën me të cilën ka shtënë në drejtim të dëmtuarit F., deri në momentin kur ka përfunduar ngjarja dhe kur e ka privuar nga jeta të ndjerin F.1, e ka patur në posedim vetëm i akuzuari F., pavarësisht faktit që i dëmtuari F., ka deklaruar se në drejtim të tij ka shtënë i akuzuari R.. Në këtë pikë, deklarimi i të dëmtuarit F., nuk ka qenë bindës dhe i besueshëm për trupin gjykues, për arsyet që do të ipen në vijim. Kurse, në anën tjetër, predhat që janë gjetur në trupin e të ndjerit F. L., predha që është nxjerrë nga trupi i të dëmtuarit A. dhe predha që është nxjerrë nga trupi i të dëmtuarit F., është vërtetuar se janë të revolës të markës “...” e kalibrit ... mm, të cilin natën kritike e ka përdorur i akuzuari F.M.. Kjo është vërtetuar në mënyrë shumë të qartë nga ekspertiza e ekspertit për armë të zjarrit dhe gjurmë të veglave z.Q. T.. Kështu, do të ishte shumë e logjikshme të besohet se në drejtim të dëmtuarit F. L. ka shtënë i akuzuari F.M., i cili me armën e njejtë ka shtënë edhe në drejtim të ndjerit F.1 L. dhe në drejtim të dëmtuarit A. L.. Në mënyrën se si është zhvilluar ngjarja natën kritike; në pozicionet e personave të involvuar në momente të caktuara; kohën e shkurtër të zhvillimit të ngjarjes; faktin se si i akuzuari R. ashtu edhe i akuzuari F., në përgjithësi, gati gjatë gjithë kohës (është fjala deri në momentin kur i akuzuari F.e ka privuar nga jeta të ndjerin F.) nuk kanë qenë afër njëri-tjetërit; pozita dhe vendi se ku kanë rënë të tokë i ndjeri A. dhe i dëmtuari F., etj. trupi gjykues ka ardhur në përfundim se i akuzuari F.M., natën kritike ka shtënë edhe në drejtim të dëmtuarit F. L. dhe nuk ka patur kurrfarë gjasa reale që i akuzuari R. M., të ketë shënë në drejtim të dëmtuarit F., siç ka deklaruar ky i fundit. Kjo edhe për faktin se predha që është nxjerr nga trupi i të dëmtuarit F., është shprehur nga arma e njejtë, e cila ka shkrepur edhe predhat që janë gjetur në trupin e të ndjerit F.1 dhe predha që është nxjerrë nga trupi i të dëmtuarit A. . Kurse, në anën tjetër, është vërtetuar se i akuzuari F., ka shtënë më këtë armë ka shtënë në drejtim të dëmtuarit A. dhe në drejtim të ndjerit F. Duke u bazuar në këto, trupi gjykues e ka vlerësuar si të besueshëm dhe bindës deklaratën e të akuzuarit F.M., i cili e ka pranuar faktin se me armën e cekur më parë natën kritike ka shtënë edhe në drejtim të dëmtuarit F. L..

Edhe një herë, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykues e ka vlerësuar të besueshëm dhe bindës deklaratën e të akuzuarit F.M., i cili e ka pranuar se i ka privuar nga jeta të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe i ka lënduar të dëmtuarit A. dhe F. L., me armën e markës”...” e kalibrit ... mm, të cilën e ka mbajtur pa autorizim dhe pa leje. Përmes këtyre që u cekën më lart, vëretohet ana objektive e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit F.M., e që konsistojnë në atë se i njejtë me armën e lartcekur i ka privuar nga jeta të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe po me këtë armë ka shtënë në drejtim të dëmtuarve A. dhe F. L.. Në anën tjetër, në disa pika, trupi gjykues nuk ja ka falur besimin deklaramit të akuzuarit F.M., për arsyet që do të ipen në vijim. Kështu, deklarimin e të akuzuarit F.M., se të njejtë natën kritike e kanë sulmuar edhe dëshmitarët A. dhe I., trupi gjykues e

ka vlerësuar si kontradiktore me vetë deklaratat e tij të mëparshme (më parë nuk e kishte deklaruar në këtë mënyrë i akuzuari F.M.), si dhe në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve A. Xh. dhe I. L., si dhe me deklaratat e të dëmtuarve A. dhe F. L.. Duke u bazuar në këto, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se dëshmitari I. L., natën kritike nuk ka qenë prezent në vendin e ngjarjes, por ai ka ardhur në vendin e ngjarjes, pasi ka përfunduar rasti, kështu edhe nuk ka patur mundësi objektive që ta sulmojë të akuzuarin F., siç nuk ka patur mundësi objektive që ta sulmojë as dëshmitari A. Xh., fillimisht e ka parë ngjarjes deri kur i akuzuari R. ka ardhur me sopatë në dorë dhe i njejtë ka qëndruar brenda oborrit të shtëpisë së të dëmtuarve. Në këto pika, trupi gjykues i ka vlerësuar si të besueshme deklaratat e dëshmitarëve A. Xh. dhe I. L., për shkak se të njejtat janë në harmoni me njëra-tjetrën, si dhe me provat tjera.

Për arsytet që janë paraqitur në pikën 6.2. të arsyetimit të këtij aktgjykimi, trupi gjykues e ka vlerësuar si jo të besueshëm deklarin e të akuzuarit F.M., i cili ka deklaruar se “kur ka shkrepur me armë kinse ka dashur që të ndjerin A. L., ka godas në dorë”, për shkak se është në kundërshtim me vetë deklarin e tij. Kjo për faktin se, siç ka deklaruar vetë i akuzuari F.M., në momentin kur ka shkrepur në drejtim të ndjerit A. L., i ndjeri ka qenë diku larg nga i akuzuari F., 1 (një) deri në 1 (një) metër e gjysmë, kurse në anën tjetër i akuzuari F. ka deklaruar se armë ka mbëjtur “non-stop”, që nga viti 1993. Kjo do të thotë, i bie që i akuzuari F.M., nuk ka dashur që të shkrep në dorën e të ndjerit A. L., edhe pse ka mundur ta bëjë një gjë të tillë, për shkak të afërsisë me të ndjerin A. L. dhe për shkak të përvojës së tij të gjatë të mbajtjes së armëve. Për arsye të njejtë, është vlerësuar e pabesueshme deklarata e të akuzuarit F.M., i cili ka deklaruar se ka dashur që të gjuajë me armë në drejtim të këmbëve të të dëmtuarit A. L., si dhe kinse “duke u larguar nga mbrapa, është rrëzuar dhe meqë e kishte në dorë revolën, janë gjuajtur predha, mirëpo nuk e ka ditur se në cilën pjesë të trupit e ka goditur të ndjerin F.1 L.”.

Në anën tjetër, është vlerësuar si jo i logjikshëm, deklarimi i të akuzuarit F.M., ku kishte deklaruar se natën kritike, së pari e kishte nxjerrë revolën, duke dashur që të gjuaj për pjet, mandej të njejtën revole e kishte futur në xhep, me qëllim që t’ia marrë revolën të cilin e posedonte i ndjeri A. L., ku më pastaj, kinse e ka nxjerrë për herë të dytë revolën, me të cilën edhe kishte shënë natën kritike.

Poashtu, e ka vlerësuar si të pabesueshëm deklarin e tij, ku kishte deklaruar se kinse, pasi që veç i kishte privuar nga jeta të ndjerët dhe kishte shtënë në drejtim të dëmtuarve A. dhe F. L., i akuzuari R. ka shkuar dhe ja ka marrë armën për të shkuar në polici, e jo për të shtënë në drejtim të dëmtuarit F.. Shtrohet pyetja pse djali. (i akuzuari R.) t’ia marrë armën babait (të akuzuarit F.), për të shkuar në polici, aq më parë kur vetë i akuzuari F. ka mundur që ta mbajë atë armë dhe vetë ai ka deklaruar, sipas të akuzuarit R. nuk ka dashur që të paraqitet në polici. Në këtë pikë, i akuzuari F., nuk e ka treguar të vërtetën, se djA. i tij – akuzuari R. pasi që veç ja kishte marrë armën, kishte dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin F. L., mirëpo nuk ka arritur që ta bëjë një gjë të tillë,

edhe pse kishte provuar tri herë, ngase arma nuk kishte patur fishekë. Në këtë pikë është vlerësuar si jo i besueshëm dhe i palogjikshëm edhe deklarimi i të akuzuarit R. M., i cili e pranon se ia ka marrë armën, por e mohon faktin se ka dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin F., derisa i njëjti ishte i shtrirë dhe i plagosur. Lidhur me këtë fakt, trupi gjykues ja ka falur besimin e plotë deklarimit të të dëmtuarit F. L., i cili e ka vërtetuar këtë fakt, në mënyrë tejet bindëse dhe një deklaram i tillë, në një mënyrë është edhe i logjikshëm, ngase edhe që të dy të akuzuarit F.dhe R. M., e kanë pranuar faktin se i akuzuari R. M., ia ka marrë armën të akuzuarit F.M., pasi i njëjti veç i kishte shtënë në drejtim të dëmtuarve A. dhe F. L.si dhe pasi që veç i kishte privuar nga jeta të ndjerët A. dhe F. L..

Trupi gjykues, gjithashtu e ka vlerësuar si të pabesueshëm deklaramin e të akuzuarit F.M., i cili ka thënë se kinse natën kritike nuk ka vërejtur se i akuzuari R. M., të ketë patur sopatë apo ndonjë mjet tjetër. Kjo për faktin se me prova tjera është vërtetuar se natën kritike i akuzuari R. M., fillimisht e ka patur në dorë një sopatë të madhe me të cilën i pari e ka filluar sulmin (dëshmia e dëshmitarit A. Xh., deklarama e të dëmtuarit F. L., etj.), kështu që nuk ka patur mundësi që mos ta shoh të njëjtin me sopatë në dorë. Përveç kësaj, është vërtetuar se natën kritike i akuzuari R. M., ka patur edhe thika, ku edhe i ka sulmuar të ndjerët F.1 dhe A. L., me qëllim që t'i privojë nga jeta. Kjo është vërtetuar nga deklaramat e të dëmtuarve A. dhe F. L.; nga rrjedha logjike e ngjarjes dhe pozicionet e personave në momente të caktuara; nga provat materiale, siç janë raportet policore, skica e vendit ngjarës, fotografitë nga vendi i ngjarjes, etj., si dhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertës Hidajete Muharremi, specialiste e lartë për serologji dhe ADN. E njëjta gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nga mostra D#23.b (dëshmia D#23 thikë) dhe mostra D#20.b (dëshmia te thikë D#20) është fituar një profil i njëjtë i ADN i cili përputhet me profilin e R. M.t (dëshmia D#16) dhe R. M. nuk mund të përjashtohet si kontributor me këto dy dëshmi. Mostra D#23.b është marr me tampon pambuku prej thikës (pjesa e dorëzës së thikës afër tehut të thikës), ndërsa mostra D#20.b është marr me tampon pambuku prej thikës (pjesa e fundit e dorëzës dhe dy pjesët e rrumbullakt). Kjo tregon se i akuzuari R. M., i ka patur në posedim këto dy thika natën kritike, ngase mostrat e ADN janë marrë prej dorzës së thikës (D#23.b), përkatësisht nga pjesa e fundit e dorëzës dhe dy pjesët e rrumbullakta (D#20.b). Këtë konstatim të ekspertës, trupi gjykues e ka vlerësuar si të besueshëm dhe bindës. Në anën tjetër, nga skica e vendit të ngjarjes, fotografitë e vendit të ngjarjes, si dhe raportet policore, shihet se thika D#20, është gjetur afër garazhës së ndërtesës në ndërtim e sipër dhe ky vend është afër vendit ku ka qenë i shtrirë i ndjeri A. L., ndërsa thika D#23, është gjetur rrugës që shkon kah drejtimi i tregut, rrugë kjo, nga edhe janë larguar nga vendi i ngjarjes të akuzuarit F. dhe R. M.. Nga legjenda e matjeve, shihet se thika D#23, ka qenë larg 15.80 metra, nga skaji ndërtesës në ndërtim e sipër (PF-2). Se të ndjerët F.1 dhe A. L., janë sulmuar me thika nga ana e të akuzuarit R. M., në një mënyrë e pranon edhe vetë ky i fundit. Gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, i akuzuari R. M., përveç tjerash ka deklaruar se “me vetëdijen e tij

natën kritike nuk e ka sulmuar askënd, mirëpo sipas tij gjatë kohës kur ia ka marrë thikën F. ka mundur të lëndohet ndokush, përkatësisht ka mundur të lëndohet A.... Gjithashtu, edhe të ndjerin F.1 ka mundur ta godas F. dhe të akuzuarit R. nuk i kujtohet që e ka goditur F.1 me thikë, por nuk përjashtohet një mundësi e tillë, sepse i akuzuari R. është munduar që të mbrohet dhe këtë thikë i njëjti e kishte lënë në vendin e ngjarjes”. Pra, sipas deklaratës së të akuzuarit R. M., i njëjti nuk e ka mohuar faktin se natën kritike ka mundur që ta lëndojë me thikë të ndjerin A., siç nuk e ka përjashtuar mundësinë që mundur ta godas me thikë edhe të ndjerin F.1, me arsyetimin se kinse ka dashur që të mbrohet. Duke u bazuar në të gjitha këto, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se natën kritike i akuzuari R. M., me qëllim që t’i privojë nga jeta me thika i ka sulmuar të ndjerët F.1 dhe A. L..

Duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lart dhe ato që do të cekën në vijim, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk duhet t’i falet besimi deklaramit të akuzuarit R. M., i cili e ka mohuar se natën kritike faktin se natën kritike ka dashur që t’i privojë nga jeta të ndjerët F.1 dhe A. L., të cilët i ka sulmuar me thika, si dhe faktit se ka mohuar se ka dashur që t’a privojë nga jeta të dëmtuarin F. L., derisa i njëjti ishte plagosur dhe i shtrirë.

Gjithashtu, deklaratës së të akuzuarit R. M., se pas mosmarrëveshjes që kishte te kioska me të dëmtuarit, kinse për qejf ka shkuar për ta marrë të akuzuarin B. B., në K., është vlerësuar si e pabesueshme dhe absurde. Pastaj, se kinse natën kritike nuk ka kontaktuar përmes telefonit me të pandehurin B. Sh., gjithashtu, është vlerësuar si e pabesueshme, ngase nga lista e PTK, shihet se i njëjti ka patur kontakt telefonik me të pandehurin B. Sh., natën kritike, në ora 22:53 minuta. Gjithashtu, edhe në shumë pika tjera, deklarata e të akuzuarit R. M., është vlerësuar si kontradiktore me provat tjera që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, siç është p.sh. fakti se kinse natën kritike nuk ka patur sopatë, gjë që është vërtetuar se i njëjti natën kritike me sopatë në dorë ka shkuar duke vrapuar në vendin e ngjarjes dhe i pari e ka filluar sulmin. Duke i parë edhe disa kontradikta tjera, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari R. M., është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, në konkest të veprimeve inkriminuese të të akuzuarit B. B., ku kishte deklaruar se “e di që një herë i akuzuari B. B. e ka shtyrë A. te mbrapa dhe nuk e ka vërejtur se ku ka shkuar”, etj.

Deklarata e të akuzuarit B. B., i cili e mohon kryerjen e veprës penale është vlerësuar si jo e besueshme dhe jo bindëse, për shkak se edhe me provat tjera, që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Përveç këtyre, edhe pse nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuarit, i akuzuari B. B., nuk e ka mohuar faktin se ka qenë në vendin e ngjarjes, si dhe nuk e ka mohuar faktin se e ka patur në posedim një shkop (llos), të cilin sipas tij ja kishte larguar një personi të involuar në rast.

Sa i përket deklaratës së të dëmtuarit A. L., përveç atyre që janë cekur më parë, lidhur me këtë deklaratë, trupi gjykues e ka vlerësuar si në përgjithësi si një deklaratë të besueshme, objektive dhe të qartë. I njëjti në mënyrë shumë të rrjedhshme ka treguar se si ka rrjedhur ngjarja natën kritike dhe deklarata e tij është në harmoni me deklaratat e tij të mëparshme. Por, në një pikë trupi gjykues e ka vlerësuar si jo bindës deklaratën e tij, kur është fjala për faktin se a ka patur thikë i akuzuari B. B., natën kritike. Lidhur me këtë, nëse i bëhet një analizë më e thellë deklaratës së të dëmtuarit A. L., të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, më datën 10.12.2013, shihet se i dëmtuari nuk ka qenë shumë i sigurt lidhur me këtë fakt. Në faqen e dytë të kësaj Deklarate, i njëjti ka deklaruar se sa i përket të akuzuarit B. B., “i njëjti ka pas diçka në dorë, nuk jam i sigurt çka ka pas kujtoj se ka qenë një armë e ftohtë”, ndërsa pas ballafaqimit me deklaratën e thënë në polici, i njëjti kishte shtuar se “po është e vërtetë se i akuzuari B. B., e ka patur një shkop në dorë, siç ka deklaruar edhe më parë në polici dhe me të e ka sulmuar xhaxhain e tij”. Ndërsa, gjatë shqyrtimit gjyqësor, i dëmtuari A. L., disi ka qenë kundërthënës dhe jo shumë i qartë sa i përket kësaj çështje. Kështu, gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me veprimet e të akuzuarit B. B., ai ka deklaruar : “të akuzuarin B. B., e kishte parë me një shkop në dorë, i cili shkop edhe nuk kishte qenë edhe shumë i gjatë, ku i njëjti ishte duke marrë pjesë në atë rrahje, duke e sulmuar axhën e tij – të ndjerin A. L., ...”, “Në momentin e fundit, në vendin e ngjarjes, i dëmtuari A. L. e kishte parë të akuzuarin B. B. duke e sulmuar axhën e tij-të ndjerin A. L., me një armë të ftohtë, e cila ka qenë e gjatë 20-30 cm, të cilin edhe nuk ka mundur që ta vërejë edhe aq mirë, ngase nuk kishte ndriqim të mjaftueshëm”, “Sa i përket asaj se çka ka poseduar natën kritike i akuzuari B. B. dhe veprimeve të tij, i dëmtuari A. L., ka shtuar se para se të plagoset e ka parë që i akuzuari B. e ka patur një mjet të fortë, ndërsa pas plagosjes e ka parë se i akuzuari B. e ka patur një thikë në dorë. I akuzuari B. B., natën kritike me grushta e ka sulmuar babain e të dëmtuarin-të ndjerin F. L., ndërsa kur është plagosur i dëmtuari A. , i njëjti e ka parë të akuzuarin B. duke e sulmuar axhën e tij-të ndjerin A. L.”. Duke u bazuar në këto, faktin se natën kritike ka qenë errësisë, si dhe në atë se pasi që është plagosur i dëmtuari A. , nuk ka mundur i njëjti edhe të jetë shumë i koncentruar se çka ka patur në dorë i akuzuari B., për shkak se i njëjti ka qenë i plagosur me armë zjarri dhe sigurisht se vëmendjalisht tij, nuk ka mundur të përqendrohet në detaje. Përveç kësaj, edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertës Hidajete Muharremi, shihet se i akuzuari B. B., nuk është i ndërlidhur me ndonjërin prej thikave që është gjetur në vendin e ngjarjes. Për arsye gati të njëjta, trupi gjykues e ka vlerësuar si jo bindës edhe deklaratën e të dëmtuarit F. L., që kishte deklaruar se e ka parë se i akuzuari B. e ka patur një thikë në dorë, mirëpo nuk e ka vërejtur nëse i njëjti ka ndërmarrë ndonjë veprim. Duke u bazuar në këto, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se i akuzuari B. të ketë patur thikë natën kritike, përveç atij shkopi (apo llosit) me të cilin edhe e ka kryer veprën penale sipas Dispozitivit V të këtij aktgjykimi.

Kur është fjala për deklaratën e të dëmtuarit F. L., e cila është marrë në shtëpinë e tij dhe në prezencën e Dr.Afrim Canës – psikiatër, trupi gjykues të njejtën e ka analizuar me çasje tejet kritike dhe me një vëmendje të posaçme, për shumë arsyë, në veçanti për shkak të gjendjes së tij të vështirë shëndetësore. Deklarata e tij në përgjithësi është vlerësuar si objektive, e qartë dhe e besueshme, sidomos për faktet që janë vërtetuar dhe që janë cekur më parë. Mirëpo, në disa pika deklarata e tij ka qenë jo shumë bindëse për trupin gjykues. Kështu, i njëjti gjatë deklaratës së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe nga skica nr.14, ka sqaruar se “i ndjeri A. L., ka qenë i shtrirë kah mesi i rrugës, por ka pjesa që shkon më afër pllacit të R. M., afër skajit të këtij pllaci, i dëmtuari F. L., ka qenë afër të ndjerit A. L., kah drejtimi i parkut..”. Trupi gjykues është i ndërgjegjshëm se i dëmtuari F., ndoshta nuk ka mundur që t’i tregojë edhe detajet më të vogla, mirëpo vendi se ku ka qenë i shtrirë i dëmtuari F. dhe axha i tij, dallon shumë nga deklarata e të dëmtuarit B. B., si dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve okular. Lidhur me këtë fakt, dëshmitari B. B., i cili është një oficer i Policisë së Kosovës, ka deklaruar se "... ka dëgjuar edhe britmë, ku edhe ka vrapuar në atë drejtim, me ç’rast te objekti në ndërtim e sipër, afër garazhës ka parë edhe dy persona. Prej këtyre dy personave, njëri ka qenë i vdekur, ndërsa tjetri ka patur shenja jete.... Revolja e lartcekur ka qenë afër objektit në ndërtim e sipër dhe ka qenë afër dy personave të shtrirë”. Pastaj, pozitën e këtyre dy personave të lënduar dhe e armës, dëshmitari B. B. e ka prezentuar në skicën nr.19. Nga kjo shihet se këta dy persona kanë qenë afër njëri-tjetrit, afër objektit që është në ndërtim e sipër dhe gjithashtu, afër tyre ka qenë edhe revolja. Një fakti i tillë, mund të vërtetohet edhe nga nga procesverbali i shikimi të vendit të ngjarjes, skica e vnedit të ngjarjes, etj. Pra, deklarimi i të dëmtuarit F. lidhur me këtë fakt është jo bindës dhe në kundërshtim me provat e lartcekura, gjë që trupi gjykues ka ardhur në përfundim se i dëmtuari F. L. dhe i ndjeri A. L., kanë qenë të shtirë afër garazhës së objektit që është në ndërtim e sipër dhe afër tyre është gjetur edhe arma e markës "...”, e kalibrit ..., me numër serik "...”. Duke u bazuar në këto, pastaj në pozicionet e personave të involvuar, etj. trupi gjykues ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi deklarimit të të akuzuarit F.M., i cili ka thënë se i ndjeri A. ka patur armë natën kritike, ngase kjo armë edhe është gjetur afër të ndjerit A1., kështu nuk ka patur kush tjetër ta ketë patur në posedim këtë armë natën kritike, pavarësisht faktit se pas ekzaminimit të bërë nuk ka mundur që të vërtetohet se kush e ka patur në posedim këtë armë. Në këtë përfundim, trupi gjykues ka ardhur edhe duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPP.²⁷

Në pikën ku ka treguar se si i akuzuar R. M., ka tentuar që ta privojë nga jeta, pasi që i njëjti ishte i plagosur dhe i shtrirë, trupi gjykues ja ka falur besimin, ngase në një mënyrë edhe të akuzuarit F.dhe R. M., e kanë pranuar faktin se i

²⁷ Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

akuzuari R. ja ka marrë armën të akuzuarit F., pasi që i njeiti i kishte privuar nga jeta të ndjerët dhe pasi që kishte shtënë me armë në drejtim të dëmtuarve A. dhe F. L.. Mirëpo, për arsyet që janë cekur më parë, kur është vlerësuar dhe analizuar deklarata e të akuzuarit F.M., trupi gjykues e ka vlerësuar si jo bindës deklaratën e të dëmtuarit F. L., i cili ka deklaruar se i akuzuari R. M., ka shtënë në drejtim të tij me armë. Gjithashtu, nuk i është falur besimi as deklaratës së të dëmtuarit F., ku ka deklaruar se “mjekët i kanë treguar se nga trupi i tij i kanë nxjerrë dy predha”. Kjo për faktin se dëshmitari S. R., oficer i Policisë së Kosovës, ka deklaruar se nga trupi i dëmtuarit F. L., është nxjerrë vetëm një predhë, e cila më pastaj është dërguar për ekzaminim. Në këtë pikë, trupi gjykues ja falur besimin e plotë deklaramit të dëshmitarit S. R., ngase i njeiti ka një përvojë të gjatë si oficer policor dhe një deklaramit i tij gjen mbështetje edhe në provat tjera materiale.

Mendimet dhe konstatimet i ekspertëve Dr.Arsim Gërxhaliu., Hidajete Muharremi dhe Qëndrim Topalli, janë vlerësuar shumë lartë nga ana e trupit gjykues, ngase janë bërë nga profesionistët që posedojnë përvojë dhe cilësi përkatëse për t’i bërë ekspertizat e tyre. Përveç atyre që është cekur më lart, vlen të përmendet edhe fakti se eksperti mjeko-ligjor, Dr.Arsim Gërxhaliu, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, e ka sqaruar më detajisht mendimin dhe konstatimin e tij lidhur me shkakun e vdekjes së të ndjerëve F.1 dhe A. L.. Sipas tij, dëmtimi i përshkruar në pikën nr.1 është shkaktar i vdekjes së të ndjerit F. L., pra kjo është plaga e cila ka sjellë vdekjen e tij, ndërsa lëndimi nr.3, është lëndim i shkallës së rëndë, por 90% e njerëzve mbijetojnë nëse dërgohen shpejtë në spital. Me fjalë tjera 90% e njerëzve vetëm sa i përket lëndimit nën pikën 3 dhe sikur të mos ekzistonte lëndimi sipas pikës 1, do të mbijetojnë, ndërsa 10% nuk do të jetojnë. Gjithashtu, eksperti mjeko-ligjor Dr.Arsim Gërxhaliu, ka deklaruar edhe shkaktari i vdekjes së të ndjerit A. L. është lëndimi nr.1 dhe sikur të mos ekzistonte ky lëndim atëherë nuk do të shkactohej edhe vdekja e të ndjerit A. L.. Ndërsa, në anën tjetër, lëndimet nr.1 të të ndjerët F.1 dhe A. L., janë shkaktuar nga predhat të cilat janë shtënë me armë të zjarrit. Poashtu ka sqaruar edhe kohën e shkaktimit të plagëve, që është tjejet e rëndësishme për të përcaktuar veprimet inkriminuese të të akuzuarve. Duke u bazuar në këto dhe në provat tjera, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se vdekja e të ndjerëve F.1 dhe A. L., ka ardhur si rezultat i të shtënave me armën e zjarrit të cekur më parë nga ana e të akuzuarit F.M..

Gjithashtu, është vlerësuar si e besueshme dhe bindëse edhe deklarata e dëshmitarit A. Xh., i cili ka rrëfyer për disa situata para dhe pas përfundimit të ngjarjes. Të gjitha këto, i njeiti i ka treguar në mënyrë të rrjedhshme dhe të qartë, si dhe këtë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale.

Trupi gjykues i ka analizuar dhe vlerësuar edhe provat tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si : deklaramit e dëshmitarëve Sh. Xh., N. M., E. M., A. K., T. M., R. E., E. R., B. B., S. R. dhe I. L.. Edhe pse këta dëshmitarë nuk kanë qenë dëshmitarë oklur, përmes këtyre dëshmitarëve janë

vërtetuar disa fakte që janë të rëndësishme në këtë çështje penale, siç mund të shihet te deklaratat e tyre.

Mirëpo, në këtë aspekt, vlen të përmendet deklarata e dëshmitarit N. M., i cili kur e kishte dërguar të dëmtuarin F. L., tek Emergjencia në Gjiilan, motra e të ndjerëve i kishte thënë se “a po e shifni se çka na banën tanët dhe e njëjta e kishte përmendur si vrasës F.”, pastaj deklarata e tij se ku i kishte gjetur trupat e të ndjerëve dhe si e kishte parë të dëmtuarin F., etj. Dëshmitari A. K., përveç tjerash, ka deklaruar se kur kishte shkuar për t’i shprehur ngushëllime familjes së të ndjerëve, babai i të ndjerëve I. L., e kishte njoftuar “se të ndjerët A. dhe F. L. i ka vrarë F.”. Dëshmitari B. B. përveç tjerash, ka deklaruar se kur kishte arritur në vendin e ngjarjes e kishte parë një person të moshuar i cili bërtiste “F.C. mi vrau djemtë”, etj. Edhe pse dëshmitë e këtyre tre dëshmitarëve, janë bazë në thëniet e personave tjerë, të njëjtat janë vlerësuar nga ana e trupit gjykues.

Pastaj, dëshmitarët E. M. dhe R. E., kanë treguar për mosmarrëveshjen që është zhvilluar paraprakisht tek kioska, etj.

Përveç këtyre dëshmitarëve dhe atyre që janë përmendur për lart, si dhe provave materiale, për të patur një vërtetim më të plotë dhe të drejtë ngjarjes, trupi gjykues edhe ka dalur dhe e ka bërë shiqimin e drejtpërdrejt të vendit të ngjarjes. Kjo është bërë edhe me qëllim të analizimit dhe vlerësimit sa më të saktë të provave.

Në fund, kur është në pyetje çështja mundësisë së shikimit dhe errësirës natën kritike, duke u bazuar në provat e lartcekura dhe pas daljes edhe në vendin e ngjarjes, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se natën kritike, edhe pse ka qenë mesnatë, ka mundur të shikohen veprimet e personave, për shkak se te dera hyrjes së shtëpisë së të dëmtuarve ka qenë një dritë që ka ndrikuar. Gjithashtu, pas daljes në vendin e ngjarjes, trupi gjykues ka konstatuar se te N. e B., e cila është disa katëshe, jetojnë familje të tëra, kështu që është e pamundur që mos të ketë patur edhe drita te kjo N., e cila gjendet shumë afër vendit të ngjarjes.

4. Elementet e veprave penale

4.1. Elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari F.M. - Sipas nenit 179 paragrafi 1 nënparagrafi 11 të KPRK, këtë formë të veprës penale të vrasjes së rëndë për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari F.M. (Dispozitivi I i këtij aktgjykimi), e kryen “kushdo që me dashje kryen dy ose më shumë vrasje, përveç veprave penale të cilat janë paraparë në nenet 180 dhe 182 të KPRK²⁸”. Pra, veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në privimin me dashje nga jeta të dy ose më shumë personave dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me jo më pak se dhjetë vjet burgim

²⁸ Në nenin 180 të KPRK, është parashikuar vepra penale vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, kurse në nenin 182 të KPRK, është parashikuar vepra penale e vrasjes së foshnjës gjatë lindjes.

apo me burgim të përjetshëm. Kurse, në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, në nenet 17 deri 21 të Ligjit për armët,²⁹ është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë,³⁰ duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.

4.2. Elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari R. M. - Siç është cekur edhe në Dispozitivin III dhe IV të këtij aktgjykimi, i akuzuari R. M., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK. Andaj, në vijim do të paraqiten vetëm nocioni dhe elementet e tentativës për të kryer vepër penale, sepse çështjet tjera që kanë të bëjnë me elementet e këtyre veprave penale janë trajtuar në pikën 4.1 të arsytimit të këtij aktgjykimi. Në këtë aspekt, tentativa për të kryer vepër penale është parashikuar në nenin 28 të KPRK. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale, por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet”.

4.3. Elementet e veprës penale për të cilat është akuzuar dhe është shpallur fajtor i akuzuari B. B. - Në nenin 190 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar forma themelore e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, të cilën konsiderohet se e kryen “Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të personit dhe për pjesëmarrje në rrahje, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vjet”. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit 190 është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, të cilin konsiderohet e kryen “Kushdo që në ndonjë rrahje ose grindje me qëllim të frikësimit apo kanosjes së personit, rrok apo vringëllon armën, mjetin e rrezikshëm apo mjetin tjetër që është i përshtatshëm për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor ose për të dëmtuar rëndë shëndetin e personit”. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet.³¹

²⁹ Ligji nr.03/L-143 për Armët, i datës 17.09.2009.

³⁰ Duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 38 të KPRK, shprehja “armë”, përveç tjerash, përfshinë edhe municionin, pjesët e armëve dhe përbërësit e armëve.

³¹ I akuzuari B. B., është akuzuar për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, ndërsa për arsytet që janë paraqitur në arsytimin e këtij aktgjykimi, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 të KPRK.

5. Gjendjalifaktike e vërtetuar, vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarve dhe rikualifikimi ligjor i veprave penale

Pas administrimit të gjitha provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, duke u bazuar në nenin 361 të KPP, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në vijim, si dhe vendosi që të akuzuarit të shpallen fajtor për këto vepra penale :

1. I akuzuari F.M., është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se me dashje i ka kryer veprat penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të KPRK (Dispozitivi I i këtij aktgjykimi) dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK (Dispozitivi II i këtij Aktgjykimin). Trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin F.M., për kryerjen e këtyre veprave penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e këtyre veprave penale dhe për të njëjtat është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se është vërtetuar se i akuzuari F.M., me dashje i ka privuar nga jeta të ndjerët A. dhe F. L., si dhe ka tentuar që t'i privojë nga jeta të dëmtuarit A. dhe F. L., me armën e zjarrit, të markës "...” e kalibrit ... mm, të cilin e ka mbajtur në posedim pa autorizim dhe pa leje valide. Si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se është i pabazuar propozimi i mbrojtësit të të akuzuarit F.M., avokatit N. N., që i mbrojturi i tij të shpallët fajtor për shkak të veprës penale vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, nga neni 180 i KPRK.³²

2. I akuzuari R. M., është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se me dashje i ka kryer veprat penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK (Dispozitivi III i këtij aktgjykimi) dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK (Dispozitivi IV i këtij aktgjykimi). Trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin R. M., për kryerjen e këtyre veprave penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e këtyre veprave penale dhe për të njëjtat është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i akuzuari R. M., me dashje ka tentuar që t'i privojë nga jeta tani të ndjerët A. dhe F. L., duke i goditur të njëjtit me thikë në pjesë të ndryshme të trupit, siç është cekur në Dispozitivin III të këtij aktgjykimi, si dhe ka tentuar që ta privojë nga jeta të dëmtuarin F. L., derisa i njëjti ishte i plagosur, me armën të cilin e kishte marrë nga babai i tij - i akuzuari F.M.. Këtë armë i akuzuari R. M., natën kritike e ka mbajtur pa autorizim dhe pa leje valide. Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP, ka ardhur në përfundim se te kualifikimi

32

ligjor i veprës penale sipas Dispozitivit III të këtij aktgjykimi, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari R. M., duhet që të shtohet edhe neni 29 i KPRK (Tentativa e papërshtatshme). Kjo për faktin se është vërtetuar se i akuzuari R. M., siç është përshkruar në Dispozitivin III të këtij aktgjykimi, natën kritike ia merr revolen nga dora babait të tij, të akuzuarit F.M., pasi i njëjti, tani veç kishte vlarë dy të ndjerët (F.1 dhe A.), si dhe kishte plagosur të dëmtuarit (F. dhe A.) dhe në një distancë rreth 2-3 metra, i drejton revolen të dëmtuarit F., po ashtu me dashje me qëllim të privimit nga jeta dhe revoles ia tërheqë këmbëzën tri herë radhazi, por që revolja nuk shkrep dhe vepra mbetet në tentativë. Nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor (deklarata e të dëmtuarit F. L., deklaratat e të akuzuarve F. dhe R. M., etj.), është vërtetuar se arma e lartcekur nuk ka patur municion, për shkak se tërë municionin e kishte shpenzuar paraprakisht i akuzuari F.M.. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, tentimi për të kryer një vepër penale me një armë që nuk ka poseduar municion konsiderohet “tentativë e papërshtatshme”. Andaj, duke u bazuar në këtë, trupi gjykues të akuzuarin R. M., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 lidhur me nenet 28 dhe 29 të KPRK (Dispozitivi III i këtij aktgjykimi), edhe pse prokurori i shtetit te kualifikimi ligjor i kësaj vepre penale nuk e ka përmendur nenin 29 të KPRK.

3. I akuzuari B. B., është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se me dashje dhe me qëllim të frikësimit apo kanosjes së personit, e ka kryer veprën penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 i KPRK (Dispozitivi V i këtij aktgjykimi). Trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin B. B., për kryerjen e kësaj vepre penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe për të njëjtën është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se është vërtetuar se i njëjti, natën kritike më dashje ka marrë pjesë në rrahje në mënyrën siç është cekur në Dispozitivin V të këtij aktgjykimi. Mirëpo, kur është fjala për veprimet e kryerjes së të akuzuarit B. B., trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se i njëjti natën kritike, ka patur thikë dhe me këtë thikë t’u ketë goditur të ndjerin A. L., në pjesën ballore të kokës, siç ceket aktakuzën e ndryshuar dhe të plotësuar gjatë fjalës përfundimtare. Kjo për faktin se nga ekspertiza e analizave të AND-së, të cilën e ka përpiluar ekspertja Hidajete Muharreme, nuk rezulton se i akuzuari B. B., të ketë patur natën kritike ndonjëren prej thikave që janë gjetur në vendin e ngjarjes, kurse në anën tjetër, deklaratat e të dëmtuarve A. dhe F. L., sa i përket këtij fakti nuk janë shumë bindëse për trupin gjykues, për arsytet që janë paraqitur në më parë në arsyetimin e këtij aktgjykimi (3.Vlerësimi dhe analizimi i provave). Duke u bazuar në këto, trupi gjykues ka vendosur që te veprimet inkriminuese të të akuzuarit B. B., të mos përfshihen edhe fjalët “të cilin poashtu në vijim të ngjarjes e godet edhe me një thikë, në pjesën ballore të kokës, duke i shkaktuar prerjen e lëkurës”, por i njëjti është vërtetuar “se më datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në

Dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ka marrë pjesë në rrahje, në atë mënyrë që duke qenë shok i ngushtë i tani të akuzuarit R. M., fillimisht, me grushta dore, e sulmon F.1L., e pastaj me një shkop të shkurtër druri, e godet tani të ndjerin A. L., në brrylin e majtë të pjesës së poshtme” dhe këto veprime janë kualifikuar si vepër penale pjesëmarrje në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 i KPRK. Edhe tek kualifikimi ligjor, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP, ka ardhur në përfundim se veprimet inkriminuese të të akuzuarit B. B., duhet të kualifikohen, sipas nenit 190 paragrafi 2 të KPRK, e jo siç ka vepruar prokurori i shtetit, i cili të akuzuarin B. B., e ka akuzuar për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje, nga neni 190 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Kjo për faktin, se sipas vlerësimit të trupit gjykues, te paragrafët 1 dhe 2 të nenit 190 të KPRK, janë parashikuar dy forma të veçanta të kësaj vepre penale dhe si tilla e përjashtojnë njëra-tjetrën. Duke u bazuar në këtë trupi gjykues ka ardhur në përfundim se veprimet e të akuzuarit B. B., duhet të kualifikohen sipas paragrafit 2 të nenit 190 të KPRK, për shkak se i njejtë natën kritike, siç është cekur edhe në Dispozitivin V të këtij aktgjykimi, ka marrë pjesë në rrahje, ku fillimisht, me grushta dore, e sulmon F.1L., e pastaj me një shkop të shkurtër druri, e godet tani të ndjerin A. L., në brrylin e majtë të pjesës së poshtme. Ky shkop i drurit (të cilin i akuzuari B. e ka quajtur “Llos”) të cilin e ka përdorur i akuzuari B. B., sipas vlerësimit të trupit gjykues është një mjet i përshtatshëm për të shkaktuar lëndimin e rëndë trupor ose për të dëmtuar rëndë shëndetin e personit, siç parashihet në nenin 190 paragrafi 2 të KPRK.

6. Vendimi për refuzimin e pretendimit të mbrojtjes për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme apo tejkalimit të kufijëve të mbrojtjes së nevojshme

Duke u bazuar gjendjen faktike të vërtetuar, trupi gjykues ka vendosur se pretendimi i mbrojtjes së të akuzuarve F. dhe R. M., avokatëve N. N. dhe V. I., për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme apo eventualisht të tejkalimit të kufijëve të mbrojtjes së nevojshme, është i pabazuar për arsyet që do të paraqiten në vijim.

1. Duke u bazuar në nenin 12 të KPRK,³³ për t’u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, duhe të ekzistojnë: a) sulmi dhe b) mbrojtja. Si sulmi, ashtu edhe mbrojtja, duhet që t’i përmbushin elementet e caktuara dhe në mungesë të ndonjërit prej këtyre elementeve, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme. Nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se natën kritike “sulmin i pari e ka filluar i

³³ Sipas nenit 12 paragrafi 2 të KPRK, mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi. Ndërsa, sipas paragrafit 3 të këtij neni, disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

akuzuari R. M.”, i cili me sopatë në dorë duke vrapuar ka shkuar te shtëpia e të dëmtuarve dhe ka dashur që t’i sulmojë të dëmtuarit, në veçanti të ndjerin F.1. Ky fakt në mënyrë tejet bindëse është vërtetuar, nga deklarata e dëshmitarit A. Xh., si dhe nga deklarata e të dëmtuarit F. L.. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, sulmi të cilin e ka ndërmarrë i akuzuari R. M., ka qenë një sulm i kundërligjshëm dhe pa bazë ligjore. Përveç që ka qenë një sulm i kundërligjshëm, ai ka qenë edhe një sulm real (i vërtetë) dhe i atëçastshëm, i cili ka qenë i drejtuar në kundër jetës dhe integritetit trupor të të dëmtuarve në përgjithësi dhe ndaj të ndjerit F. L., në veçanti. Si rezultat i kësaj dhe duke u bazuar në nenin 12 të KPRK, çdo person ka patur të drejtë që ta zbraps një sulm të tillë (i kundërligjshëm, real dhe i atëçastshëm), me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi, aq më parë kur një sulm i tillë vije para dyerve të shtëpisë së të dëmtuarve dhe në kuadër të rrugës që është pronë e të dëmtuarve (rruga para objektit që është në ndërtim e sipër). Pra, të dëmtuarit në këtë situatë, kanë qenë në rrethanat e mbrojtjes së nevojshme (“mbrojtje e ligjshme”) dhe si rezultat i kësaj nuk është lejuar mbrojtja e nevojshme kundër të dëmtuarve, të cilët kanë vepruar në mbrojtje të nevojshme. Me fjalë tjera, nuk është lejuar “mbrojtja e nevojshme kundër mbrojtjes së nevojshme”. Duke u bazuar në këtë, i akuzuari F.M., nuk ka patur kurrfarë të drejte dhe kurrfarë bazë ligjore që t’i kryejë veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, kinëse për ta mbrojtur djalin e tij – të akuzuarin R. M.. Pra, i akuzuari F.M., nuk ka patur të drejtë që t’i sulojmë të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe të dëmtuarit A. dhe F. L., me pretekstin se ka dashur që ta mbrojë djalin e tij-të akuzuarin R. M..

2. Nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se të shtënat me armë nga ana e të akuzuarit F.M., janë bërë derisa i njejtë ka qenë afër të ndjerëve A. dhe F. L., si dhe afër të lënduarve A. dhe F. L.. Kurse, në anën tjetër, gjithashtu, nga këto prova (në veçanti, ato mjekësore), shihet se ndaj të ndjerëve A. dhe F. L., si dhe të dëmtuarve A. dhe F. L., ka shtënë me armë në pjesët më vitale të trupit, ndërsa në anën tjetër, i akuzuari F.M., revolën e ka mbajtur që nga viti 1993. Duke u bazuar në këto tri rrethana (afërsia e të akuzuarit F.M., me të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe me të dëmtuarit A. dhe F. L., në momentin kur ka shtënë në drejtim të tyre; pjesët e trupit të ndjerëve dhe të dëmtuarve ku është shtënë me armë nga ana e të akuzuarit F.M., si dhe kohën e gjatë që ai ka mbajtur armë), trupi gjykues ka ardhur në përfundim se i akuzuari F.M., natën kritike nuk ka dashur që ta evitojë ndonjë “veprim të të ndjerëve apo të dëmtuarve”, por qëllimi dhe dashja e tij ka qenë e orientuar në privimin e tyre nga jeta, gjë që edhe e ka arritur pjesërisht këtë synim, ngase ka privuar nga jeta të ndjerët F.1 dhe A. L., ndërsa ka tentuar që t’i privojë nga jeta të dëmtuarit A. dhe F. L., duke ju shkakuar lëndime të rënda trupore të njejtëve. Sikur dashja dhe qëllimi i akuzuarit F.M., të ishte për t’i penguar të ndjerët apo të dëmtuarit, atëherë ai këtë do të mund t’a bënte duke i goditur të njejtë në pjesët jo vitale të trupit, siç janë duart, këmbët, etj. Por ai nuk ka dashur që ta bëjë një gjë të tillë,

edhe pse sipas vlerësimit të trupit gjykues, ka mundur që ta bëjë një gjë të tillë, por qëllimi i tij, ka qenë që t'i privojë nga jeta të ndjerët dhe të dëmtuarit, përkatësisht që t'i vras të njejtit. Një përfundim të tillë të trupit gjykues, mund të argumentohet edhe me numrin e madh të të shtënave ndaj të ndjerit F. L. nga ana e të akuzuarit F.M.. Pra, të gjitha këto tregojnë, se i akuzuari F.M., natën kritike, nuk ka patur asnjë qëllim tjetër, përveç se që t'i privojë nga jeta të ndjerët dhe të dëmtuarit. Poashtu, edhe nga vendi se ku janë goditur të ndjerët me thikë nga ana e të akuzuarit R. M.; mënyrën se si ka vepruar i njejtë; mënyrën dhe rrethanat se si është zhvilluar ngjarja; mosmarrëveshjen e mëparshme të tij që është zhvilluar afër kioskës; përgatitjes e tij pas kësaj mosmarrëveshje (duke u pajisur me thikë dhe sopatë, duke shkuar dhe marrë të akuzuarin B. B., në Kamenicë; duke e kontaktuar në telefon babain e tij – të akuzuarin F.M. dhe me të pandehurin B. Sh.; këmbëngulësin e tij; vrazhdësinë e veprimeve të tij, duke dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin F. L., derisa i njejtë kishte qenë i shtrirë në tokë dhe i plagosur paraprakisht nga i akuzuari F.M.; paramendimin dhe planifikimin e tij, etj. tregojnë se i akuzuari R. M., ka dashur që të ndjerët dhe të dëmtuarin F. L. t'i privojë nga jeta, përkatësisht dashjëadhe synimi i të akuzuarit R. M., ka qenë e orinetuar që të ndjerët F.1 dhe A. L., si dhe të dëmtuarin F. L., t'i privojë nga jeta.

3. Një tjetër argument të cilin e ka marrë për bazë trupi gjykues për të refuzuar pretendimet e mbrojtjes, është edhe pozita e të ndjerëve në momentin kur janë goditur me armë zjarri nga ana e të akuzuarit F.M.. Kështu, nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.Arsim Gërxhaliu, të paraqitur edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor shihet se ndjeri F. L., ka pësuar disa lëndime me armë zjarri në momentin kur trupi i tij ka qenë në rënie. Kështu, eksperti Dr.Arsim Gërxhaliu, ka deklaruar lëndimi nr.2 te i ndjeri F. L. është shkaktuar me armë zjarri gjatë krresjes – rënies trupore. Poashtu, edhe lëndimi nr.4, është shkaktuar me armë zjarri gjatë kohës kur trupi i të ndjerit F. L., ka qenë në pozicionin e rënies. Në anën tjetër, edhe plaga fatale të cilën e ka pësuar me armë zjarri i ndjeri A. L., shihet drejtimi i predhës është nga lart shumë lehtë poshtë, përkatësisht pozicioni i të ndjerit A. L., në momentin e goditjes me armë zjarri ka qenë lehtësisht i krresues. Pozita e të ndjervë F.1 dhe A. L., tregon që i akuzuari F.M., ka shtënë në kohën kur trupi i të ndjerit F. L. ka qenë në pozicionin e rënjes (duke mos e përfëshirë këtu plagën nr.1 me armë zjarri), përkatësisht pozicioni i të ndjerit A. L., ka qenë lehtësisht i krresur në momentin kur është shtënë me armë zjarrit nga ana e të akuzuarit F.M.. Pra, vetë pozita e të ndjervë në momentin e goditjes me armë zjarri nga ana e të akuzuarit F.M., jep të kuptojmë se këtu, absolutisht as që mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme.

4. Pas daljes dhe shikimit në mënyrë të drejtpërdrejt të vendit të ngjarjes, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se natën kritike, si i akuzuari F.M., ashtu edhe djali i tij-i akuzuari R. M., kanë mundur që t'i shmangen këtij rasti, edhe

pasi që kanë arritur në vendin e ngjarjes, duke ikur nga rruga e tregut, apo kah rruga që shkon në drejtim të kioskës. Mirëpo, ata nuk e kanë bërë një gjë të tillë, edhe pse kanë patur mundësi, por pas përgatitjeve të caktuara dhe sigurimit të armëve, kanë shkuar në vendin e ngjarjes, para dyerve të shtëpisë së të dëmtuarve për t'i kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

5. Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se si i akuzuari F.M., ashtu edhe i akuzuari R. M., e kanë provokuar dhe nxitur këtë rast dhe kryerjen e veprave penale e kanë përgatitur paraprakisht dhe këtë e kanë bërë me paramendim. Bile, sipas vlerësimit të trupit gjykues, i akuzuari F.M., edhe e kishte patur të përgatitur edhe armën e zjarrit, në mënyrë që e njejtja të funksionojë dhe të shkrep menjehere, pra armën e ka patur në gjendje gadishmërie për shkrepje. Të gjitha këto dhe jo vetëm këto, janë rrethana që tregojnë se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme, por pretendimet e mbrojtësve, sipas vlerësimit të trupit gjykues, janë bërë thjeshtë me qëllim të lehtësimit të pozitës së të akuzuarve F. dhe R. M., gjatë marrjes së aktgjykimit dhe shqiptimit të dënimeve.

7. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese që janë marrë për bazë me rastin e matjes të dënimeve

Me rastin e matjes së dënimeve ndaj të akuzuarve, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë cakimin e llojit dhe lartësisë së dënimeve, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK.

7.1. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit F.M. - Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit F.M., trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin F.M., trupi gjykues i ka marrë faktin se i njëjti gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, të datës 22.10.2014, kishte deklaruar se jam penduar për veprat penale të cilat i kam kryer; të dëmtuarve i kishte kërkuar falje dhe ju kishte shprehur ngushëllime për vdekjen e anëtarëve të familjes. Gjithashtu, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin F.M., trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i njëjti është i martuar dhe është babë i tre fëmijëve. Ndërsa, trupi gjykues si rrethana rënduese për të akuzuarin F.M. e ka marrë për bazë këto rrethana :

- se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale me aktgjykime të formës së prerë. Kështu, i akuzuari F.M., me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.396/2010, i datës 20.02.2012, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1

të Kodi Penal i Kosovës;³⁴ me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.262/2008, i datës 18.07.2011, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1 të KPK dhe me aktgjykimin tjetër të formës së prerë të po kësaj Gjykate, P.1056/08, i datës 26.10.2011, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura, nga neni 272 paragrafi 1 të KPK;

- se i njejt i ka qenë në arrati nga nata kritike e deri më datën 25.11.2013;
- paramendimin e tij për të kryer veprat penale;
- motivin për kryerjen e veprave penale, i cili ka qenë i natyrës pronësore, për shkak të problemeve në lidhje me shfrytëzimin e rrugës që shpie në rrugën kryesore;
- pasojat tejet të rënda të veprave penale të kryera dhe numri i madh i viktimave. Si rezultat i veprimeve të tij inkriminuese, janë privuar nga jeta dy vëllezër, të cilët kanë qenë kryefamiljar në familjet e tyre dhe të cilët kanë lënë fëmijë dhe bashkëshortet e tyre. Përveç që janë privuar nga jeta dy vëllezër (të ndjerët A. dhe F.1), lëndime të rënda trupore kanë pësuar dhe dy djemtë e të ndjerit F.1, A. dhe F.. Aq më keq dhe më rëndë ka pësuar i dëmtuari F., të cilit i kanë shkaktuar lëndime të rënda me pasoja të përhershme për shëndetin e tij, i njejt i ka mbetur i paralizuar në pjesën e poshtme të trupit dhe për të duhet që çdo herë të kujdeset një person i tretë. Të gjitha këto, janë vërtetuar duke u bazuar në raportet mjekësore. Këto tregojnë, se kësaj familje (familjes L.) i janë shkaktuar pasoja tejet të rënda;
- të gjitha të këto pasoja të rënda, familjes L. janë shkaktuar nga ana e të akuzuarit F.M., i cili është në raporte familjare me këtë familje. I akuzuari F.M., e ka privuar nga jeta dhëndërin e motrës së tij (F.1), përkatësisht i njejt i bashkëshorten e të ndjerit F.1, V e ka vajzë të motrës së tij;
- në vend se i akuzuari F.M., duke e patur për bazë moshën e tij, të ndërhyjë, në mes të djalit të tij R. dhe të dëmtuarve, në mënyrë që mos të vijë deri te më e keqja, ai përkundrazi, pajiset më revole, të cilën e kishte mbajtur një kohë të gjatë dhe i privon nga jeta të ndjerët A. dhe F.1, ndërsa lëndime të rënda ju shkakton të dëmtuarve A. dhe F.,
- se i akuzuari F.M., natën kritike, ka shkuar dhe ka hyrë brenda oborrit të shtëpisë, me revolën të cilën e kishte marrë me vete dhe gjithë kjo ngjarje tragjike ka ndodhur para dyerve të shtëpisë së të ndjerëve dhe në kuadër të rrugës që është pronë e tyre. Si rezultat i kësaj, natën kritike, në bazë të provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se të ndjerët A. dhe F.1, i kanë shikuar dhe parë në vend të ngjarjes të përgjakur edhe anëtarët e tjerë të familjes së

³⁴ Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

tyre (babai i tyre, tani i ndjerë I. L.; nëna e tyre; bashkëshortet e tyre, etj.), si dhe

- vendosmërinë e të akuzuarit F.M., për të kryer veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, gjë që vërtetohet nga fakti se i njejti natën kritike ka shtënë me revolën e tij, deri kur i ka shpenzuar të gjithë fishekët.

7.2. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit R. M. - Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin R. M., janë marrë për bazë fakti se i njëjti gjatë fjalës përfundimtare ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur, si dhe sipas deklaratës së tij, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali, besimin, i njëjti është babë i ... fëmiju. Ndërsa, si rrethana rënduese, në veçanti është marrë për bazë fakti se i akuzuari R. M., edhe më parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë për disa vepra penale. Kështu, i akuzuari R. M., me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.1080/2009, të datës 23.08.2012, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë P.nr.1184/2011, të datës 26.09.2013, të kësaj Gjykate, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë P.nr.493/2013, të datës 22.12.2014, të kësaj Gjykate, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK; me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.191/2007, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 154 paragrafi 2 nënparagrafi 3 lidhur me nenin 23 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.161/2009, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK dhe gjithashtu, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.162/2009, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 1 të KPK.

Gjithashtu, për të akuzuarin R. M., trupi gjykues me rastin e matjes së dënimit i ka marrë për bazë edhe këto rrethana rënduese:

- se i njejti ka qenë në arrati nga nata kritike e deri më datën 25.11.2013;
- këmbëngulesinë për t'i kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor;
- paramendimin dhe planifikimin paraprak të tij për të kryer veprën penale sipas dispozitivit III të këtij aktgjykimi;

- vrazhdësinë e veprimeve të tij, duke dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin F. L., derisa i njejtë kishte qenë i shtrirë në tokë dhe i plagosur paraprakisht nga i akuzuari F. M. dhe
- motivin për kryerjen e veprave penale, i cili ka qenë i natyrës pronësore, për shkak të problemeve në lidhje me shfrytëzimin e rrugës.

7.3. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit B. B. - Si rrethana lehtësuese, për të akuzuarin B. B., trupi gjykues i ka marrë për bazë sjellët e mirë të tij gjatë seancave të shqyrtimit. Ndërsa, si rrethanë rënduese, është marrë për bazë fakti se i akuzuari B. B., me aktgjykimin e formës së prerë, të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, P.298/2012, i datës 25.03.2013, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK. Gjithashtu, si rrethanë rënduese për të akuzuarin B. B., është marrë edhe për bazë fakti se i njejtë nuk i është përmbajtur rendit shtëpiak gjatë kohës sa i njejtë ka qenë në paraburgim, ngase në dhomën e tij është gjetur një telefon mobil, ku edhe i akuzuari e kishte pranuar se është i tij.

8. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale të kryera dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vjetëve ndaj të akuzuarve F.M.; dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj ndaj të akuzuarit R. M.,³⁵ si dhe dënimi me burgim prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj ndaj të akuzuarit B. B., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën dhe pasojat e veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarve.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënime do të mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

9. Vendimi lidhur me paraburgimin

³⁵ Në nenin 80 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të KPRK, është parashikuar se nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej 25 (njëzetepesë) vjetësh.

Duke u bazuar në nenin 367 paragrafët 1, 2 dhe 7 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarve F. dhe R. M., vazhdohet paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimet e shqiptuara, për shkak se ndaj tyre është shqiptuar dënim mbi 5 (pesë) vjet burgim. Ndërsa, ndaj të akuzuarit B. B., ndërprehet paraburgimi dhe i njehti do të lirohet më datën 15.07.2015, ngase nuk ka arsye ligjore për mbajtjen e mëtejme në paraburgim.

Duke u bazuar në nenin 83 paragrafët 1 dhe 4 të KPRK, të akuzuarve F. dhe R. M., koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.11.2013 deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, do t'ju llogaritet në dënimin e shqiptuar, ndërsa të akuzuarit B. B., koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.11.2013 e deri më datën 15.07.2015, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Llogaritja e paraburgimit do të bëhet në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

10. Vendimi lidhur me konfiskimin

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafët 1 dhe 2 nënparagrafi 2.6; nenin 69 dhe nenin 374 paragrafi 3 të KPRK, si dhe në nenin 282 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që të konfiskohen këto armë - sende : 1 (një) armë e zjarrit, e markës "...", e kalibrit, ..., me numër serik "...", me karikator; ... armë e zjarrit, e markës "...", e kalibrit ..., me numër serik "...", me karikator dhe ... fishekë; 2 (dy) sopata; 3 (tri) thika; 1 (një) fotrollë e thikës; 1 (një) palë dana; disa rroba; 1 (një) shufër metalike e ndarë në dy pjesë dhe 1 (një) drapër.

11. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që të dëmtuarit F. dhe A. L., si dhe familjarët e të ndjerëve F.1 dhe A. L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohen në kontest civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të këtyre kërkesave.

12. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarit t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale. Kështu, të akuzuarit F.M., R. M. dhe B. B., janë detyruar që secili veç e veç t'a paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 200 € (dyqind Euro) dhe në mënyrë solidare ta paguajnë shumën prej 140.88 € (njëqindedyzet Euro e tetëdhjetetë cent) në emër të kompensimit të ekspertëve mjekësor, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën në pjesën arsyetuese, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 18.08.2015

Sekretarja juridike,
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.